



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.4(430)

PRILL 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## 105 VJETORI I LINDJES

### RAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË



FAQE 4

## HOMAZH

### LAMTUMIRË SOTIR BUDINA

Shuhet emblema e qëndresës ndaj pushtesve nazifashistë



MAKSIM VINÇANI

FAQE 2

## PERSONAZH

### FPU: PROF. DR. SALI KURTI "PERSONALITETI I VITIT"



FAQE 16

BASHKËPUNIMI/ Takim mirëkuptimi mes drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të LANÇ "Nderi i Kombit" dhe të OBVL

# DY ORGANIZATAT E VETERANËVE, BASHKË

# NË 80-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

## KUSHTUAR KOSOVËS

### Halil RAMA

Shtatëmbëdhjetë vite më parë, Presidenti shqiptar Alfred Moisiu, ndërsa e ka falënderuar Presidentin George W.Bush për vizitën historike në Shqipëri, për rolin dhe ndihmën e pakursyer ndaj popullit të Kosovës, i ka thënë se pavarësia e Kosovës nuk duhet shtyrë më tej. Kjo, sipas ish-kreut më të dinjitetshëm të shtetit shqiptar për faktin se çdo vonesë mund të prodhonte destabilitet, ashtu si çdo përpjekje për të ndarë Kosovën mund të nxiste një reaksion zinxhir, i cili do të ishte me pasoja shumë të rrezikshme për tërë rajonin.

VIJON NË FAQEN 12

## PËRKUJTIMORE

### Musine Kokalari, historia e dhimbshme e disidentes

FAQE 7

## OPINION

### BRAKTISJA E FRIKSHME E MALËSISË

Nga Mevlud BUCI

FAQE 5

## POEZI

### TRIMËRI, GUXIM, MENÇURI..... CIKËL ME POEZI NGA ÇOBO SKËNDERI

FAQE 13



Kryesia e OBVL-së përshëndet këtë përafrim qëndrimesh për faktin se që në deklaratën e parë pas krijimit (27 korrik 1994) kryesia e organizatës sonë do të shprehej se: "Ne duam bashkim dhe angazhohemi totalisht për arritjen e tij mbi parimet e drejta të mirëkuptimit dhe tolerancës ashtu si na takon dhe si i nevojitet Shqipërisë"

Nga Muharrem GJOKA - Nënkrjetar i OBVL


FAQE 9

## OPINION / DIALOGU KOSOVË - SERBI ENDE NË "QORRSOKAK"

Nga Bashkim Hisari

FAQE 8

## SUPLEMENTI LETRAT



### Mesazhi i bashkshortes së shkrimtarit Shefki Karadaku

Nadire Karadaku është ndoshta nga zonjat e rrala jo vetëm si frymëzuese e krijimtarisë së bashkeshortit të saj të ndjerë, shkrimtarit të mirënjohur e shumë të suksesshëm, Shefki Karadaku, por edhe mbështetësja e financuesja e botimit të 20 librave të tij

FAQE 15

## 80-VJETORI

### BRIGADA E VIII-TË S SHKROI ME GJAK TRIUMFIN NDAJ FASHIZMIT

FAQE 3

## 124 VJETORI I LINDJES

### SEJFULLA MALESHOVA, BURRE SHTETI DHE NJERI I LETRAVE

Nga DAUT HOXHA

FAQE 6

## IN MEMORIAM

### FILLORETA FEJZO, GRUA DHE LUFTËTARE DINJITOZE

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 7

## 80-VJETORI I RËNIES

### SAMI GOLEMI BIRI I FUSHËBARDHËS GJAKUN E ÇIMENTOI ME LIRINË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 10

## KULTURË

### PUKA KRAHINË ETNOGRAFIKE

Xhemal MEÇI

FAQE 10

## DËSHMORI ABEDIN SHAQO LLAPI

### VDEKJA DHE KRENARIA JUAJ ËSHTË LIRIA JONË

Nga Neki Çako

FAQE 11

## HOMAZH

Shuhet emblema e qëndresës ndaj pushtesve nazifashistë, i diplomuar në Akademinë Ushtarake “Kujbishev” në Moskë.

# Nga njësitet guerile, në funksione të larta në ushtri - kush ishte kolonel Sotir Budina

Maksim VINÇANI\*

**S**otir Budina, ndër gurilasit e parë korçarë, ish partizan dhe kuadër i Brigadës së IV-t S dhe i ushtrisë shqiptare, i diplomuar në Akademinë Ushtarake “Kujbishev” në Moskë. ndërroi jetë më 28 shkurt në moshën 97 - vjeçare. Ai ishte një nga personalitetet e shquara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të Ushtrisë Shqiptare dhe Shoqërisë Civile të pas viteve '90-të.

Drejtues të OBVL, familjarë, miq dhe të afërm e pëcollën atë me të gjitha nderimet që meritonte.

Pranë arkivolit me trupin e tij bënë homazhe ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu, i shoqëruar nga nënkryetari i OBVL Muharrem Gjoka - Mjeshtër i Madh dhe Sekretari i Përgjithshëm i OBVL Halil Rama - Mjeshtër i Madh.

Fjalën e lamtumirës, në varrezat e Sharrës ku prehet trupi i tij e mbajti nënkryetari i OBVL Maksim Vinçani. Më pas, Z. Vinçani, së bashku me Sekretarin e Protokollit Trifon Llupo, vendosën një kurorë me lule në emër të kryesisë së organizatës tonë.

## JETËSHKRIMI



**SOTIR BUDINA** ka lindur në qytetin e Korçës në mars të vitit 1927 në një familje patriotike, e cila njihet për kontributin e shquar që ka dhënë për rritjen e ndjenjave patriotike dhe për pjesëmarrjen me armë në dorë në Luftën Nacionalçlirimtare. Nga kjo familje në luftën partizane kanë marrë pjesë katër luftëtarë.

Sotiri, i frymëzuar me ndjenjat patriotike të familjes së tij, ka marrë pjesë aktivisht në luftën për liri që në vitin 1939.

Mbasi mbaroi shkollën Normale të Elbasanit, si i ri antifashist bëhet anëtar i njësitit gueril të qytetit të Korçës, ku mori pjesë trimërisht në disa aksione luftarake kundër pushtesit fashist të vendit.

Si një nga personazhet realë në librin “Copëza jete invalidësh, (Botim i kryesisë së Degës së Invalidëve të LANÇ, Tiranë), Sotir Budinës i dilnin parasysh si në ndonjë film ngjarjet e shtatorit 1943. Në këtë libër janë



skalitur ngjarje heroike të guerilasve korçarë, mes të cilëve edhe Sotiri, i plagosur gjatë një përlëshjeje masive me armikun. U shërua falë përkujdesjes së mjekut partizan Petraq Progrit, nga dëshmia autentike e të cilit Sotir Budina gëzonte edhe Statusin e Invalidit të LANÇI.

Sotir Budina, që me formimin e Brigadës së IV-të S më 28 dhjetor 1943, u rreshtua në Batalionin e III-të të kësaj brigade, fillimisht me detyrën përgjegjës rinie kompanie dhe më vonë përgjegjës rinie i këtij batalioni. Në kujtimet e tij (të botuara), ndër të tjera ai shkruan se “Pa përfunduar plotësisht organizimi Brigada mori detyrën për të goditur forcat balliste të grumbulluara nga zona e Korçës, Kolonjës, Skraparit dhe të Tomorricës që kishin ndërmarrë sulme në shpinë të batalioneve partizane që vepronin në Gorë, Mokër, Opar, Voskopojë, Vithkuq e Rrëzë të Korçës. Përrurimin e saj Brigada IV Partizane e bëri duke sulmuar armiqtë. Luftimet e Brigadës IV Sulmuese ndikuan në dështimin e Operacionit Armik të Dimrit në qarkun e Korçës. Brigada IV S, si të gjitha brigadat e tjera të UNÇSH, i kreu me sukses të plotë detyrat e ngarkuara. Ajo luftoi në krahinat e Korçës, në Skrapar, Kolonjë, Pogradec, Mat, Peshkopi, Elbasan, Durrës e Tiranë. Një nga betejat më të njohura e heroike të Brigadës së katërt është ajo e Mushqetasë, e cila ishte vendimtare në çlirimin e Tiranës”.

Bashkohësit e mbanin mend Sotirin si partizanin trim që hidhej me guxim në aksionet luftarake, duke u bërë emblema e qëndresës kundër pushtesit.

Referuar kujtimeve të ushtarakëve të misionit britanik në Shqipëri, që kanë shkruar në kujtimet e tyre se partizanët janë shumë të ndershëm dhe shumë seriozë në përpjekjet e tyre, Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj shkruan se partizanët kishin frymë luftar-

ake, shpirt spartanësh dhe shfaqje trimërore. I tillë ishte edhe Sotir Budina, ndër guerilasitë parë korçarë dhe partizan e kuadër drejtues në formacione të Brigadës së IV-t S.

Si i ri i dalluar që ishte, në gusht 1944 u zgjedh delegat i Brigadës së IV-të S dhe mori pjesë në Kongresin e I-rë të Rinisë Antifashiste shqiptare në Helmës të Skraparit. Jas i e kujtonte ai këtë ngjarje të rëndësishme në historinë e LANÇ-it: “Në verën e vitit 1944, kur lufta kundër pushtesit kishte marrë përmasa të mëdha në të gjithë vendin dhe kur trupat sovjetike po i afroreshin Ballkanit Perëndimor, Organizata e Rinisë Antifashiste Shqiptare, e drejtuar me guxim e mençuri nga Sekretari i saj i Parë, Nako Spiru, thirri Kongresin e saj të parë në Helmës të Skraparit. Në këtë vend malor që edhe në të kaluarën ka qenë vatër e çetave të Rilindjes sonë Kombëtare, më 8 gusht 1944, në frymën e një entuziazmi të papërshkruar u hap Kongresi i I-rë i Rinisë Antifashiste Shqiptare”. Në këtë kongres mes 285 delegatëve (nga të cilët 72 ishin të reja) që përfaqësorin rininë dhe pionierët e të gjitha krahinave dhe qyteteve të Shqipërisë dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ishte edhe i riu korçar Sotir Budina. Shpesh herë ain ë mjedise familjare dhe me shokë tregonte se si me një dashuri dhe entuziazëm të paparë u pritën delegatët e Divizionit të I-rë S, të Brigadave të I-rë, IV-t dhe të V-të Sulmuese, gjithsesj 27 veta që vinin nga vija e parë e luftës për çlirimin e Shqipërisë së Veriut, duke marshuar më këmbë me qindra kilometra nga Mirdita dhe Dibra deri në Helmës të Skraparit, për të marrë pjesë në këtë kongres historik të Rinisë Antifashiste Shqiptare ku do të behej bilnaci i luftimeve dhe do të caktoheshin detyrat deri në çlirimin e plotë të atdheut.

“Zëri i delegatëve të Divizionit të I-rë, të zgjedhur nga partizanët më të mirë, të dalluar në luftën kundër pushtesve, në takimet dhe bisedat e zjarrta që bëheshin gjatë ditëve të zhvillimit të Kongresit, dëgjohej me vëmendje të veçantë. Me diskutimet e tyre, Fatmir Gjata, Dhori Panariti, Katina Starjo etj dhanë një kontribut të vyer për përcaktimin e detyrave imediate që i dilnin Rinisë”,-tregonte Sotiri.

Mbas çlirimit të vendit, Sotir Budina si ish pjesëmarrës aktiv në LANÇ dërgohet për studime në ish Bashkimin Sovjetik, ku mbaroi me rezultate të larta shkollën 3-vjeçare të xhenios në Leningrad dhe Akademinë Ushtarake të xhenios “Kujbishev”, 6 vjet në Moskë.

Si kuadër ushtarak i përgatitur dhe i pajisur me njohuri të thella të artit ushtarak të kohës, ai mbaroi mbarimit të Akademisë, në të gjitha funksionet që iu ngarkuan: Shef i Xhenios së Mbrojtjes Bregdetare, Shef i Xhenios së Mbrojtjes Kundërrjore të vendit, Shef i Katedrës së Xhenios në Akademinë Ushtarake dhe më vonë nga viti 1974-1982 për 9 vjet, nëndrejtor i Drejtorisë së Xhenios e Fortifikimit në Ministrinë e Mbrojtjes, duke punuar me përkushtim dha një kontribut të vyer në përgatitjen xheniere të ushtrisë dhe sidomos në fortifikimin e vendit.

Mbas daljes në pension në vitin 1982 dhe sidomos pas vitit '90 ka mbështetur vazhdimisht proceset demokratike.

Sotir Budina ishte një nga 64 firmëtarët e krijimit të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ përkrah personaliteve të shquara si Dr.Ymer Dishnica - Nderi i Kombit, Gjeneral Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit; gjeneral Nexhip Vinçani-Nderi i Kombit, ish-Presidentit Alfred Moisiu, gjeneral Muhamet Prodani; Liri Belishova, Edip Ohri, Skender Malindi etj.

Për 30 vjet në këtë organizatë, si sekretar Organizativ dhe prej dy vitesh si kryetar i saj, Sotiri ka dhënë një kontribut të shquar për mbarëvajtjen e saj dhe për zgjidhjen e problemeve që kanë veteranët.

Ai gëzonte Statusin e Invalidit të LANÇ. Duke vlerësuar kontributin e tij, Kryesia e Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të LANÇ, me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, me vendim të posaçëm nderoi Invalidin e LANÇ Sotir Budina me titullin e lartë “Atdheu ju është përjetë mirënjohës”.

Me vdekjen e tij, OBVL dhe Shoqata Kombëtare e Invalidëve të LANÇ humbën anëtarin dhe drejtuesin e denjtë, familja e tij humbi njeriun më të dashur, ne shokët e miqtë e tij humbëm bashkpuntorin më të ngushtë, të cilin do ta kujtojmë gjithnjë me nderim të veçantë.

\* Nënkyetar i OBVL

## PËRKUJTIMORE

“Sfidoi regjimin komunist”, Ambasada e SHBA përkujton gruan që me guxim sfidoi regjimin komunist

# MUSINE KOKALARI,

## historia e dhimbshme e disidentes

Ambasada e SHBA në Tiranë ka përkujtuar më 19 mars 2024 Musine Kokalari. Sipas njoftimit të ambadës, historia e Kokalarit, që me guxim sfidoi regjimin komunist në vend dhe luftoi për demokraci, është një histori që frymëzon edhe sot.

“Gjatë Muajit të Historisë së Gruas, ne nderojmë gratë e shquara që kanë ndryshuar botën, përfshirë Musine Kokalari, një nga gratë më të guximshme shqiptare që sfidoi regjimin komunist.

Musine Kokalari (1917–1983) ishte shkrimtare, politike shqiptare dhe themeluese e Partisë Social-Demokrate të Shqipërisë në vitin 1943. Pavarësisht se ishte një nga shkrimtaret e hershme të botuara në Shqipëri, ajo u përball me persekutimin nga regjimi komunist, i cili çoi në varfëri dhe izolim deri në vdekjen e saj. Refuzimi i saj për t’u përshtatur me një diktaturë dhe dashuria e saj për Shqipërinë na frymëzon edhe sot”, shprehet ambasada amerikane në Tiranë.



### KUSH ËSHTË MUSINE KOKALARI

Pas Luftës së Dytë Botërore u ftua nga Sejfulla Malëshova që të merrte pjesë në Lidhjen e Shkrimtarëve. E përndjekur nga pushkatimi i vëllezërve dhe duke qenë themeluese e partisë Social-Demokrate dhe organit të shtypit Zëri i lirisë, u arrestua më 17 janar 1946 dhe e mbajti 17 ditë

në burg. Më 2 korrik të po atij viti, u dënua me 20 vjet burgim nga gjykata ushtarake e Tiranës si sabotatore dhe armike e popullit. Pak përpara arrestit i dërgoi një letër Aleatëve, të cilët ende ishin në Tiranë. Në letrën e saj kërkonte zgjedhje të lira dhe lirinë e shprehjes. Në gjykatë, Kokalari mbajti këtë qëndrim:

“Nuk kam nevojë që të jem komu-

niste për ta dashur vendin tim! Unë e dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste. Unë e dua progresin e tij. Edhe pse ju keni fituar luftën, edhe pse ju keni fituar zgjedhjet, ju nuk mund t’i persekutoni ata që kanë mendime të ndryshme politike nga ato tuajat. Unë mendoj ndryshe nga ju, por unë e dua vendin tim. Ju po më dënoni për idetë e mia. Unë nuk kërkoj falje, sepse unë nuk kam bërë asnjë faj!”

Më 1964, pas 18 viteve burgim në Burgun e Burrelit, e izoluar dhe nën vëzhgim, kaloi 19 vitet e tjera të jetës së saj e internuar në Rrëshen. Musineja punoi fshesare dhe 11 vjet në ndërmarrjen e Ndërtimit në Rrëshen, mes tullave, llaçit dhe betonit. Kur i mbaroi internimi më 1979 i thanë të shkonte në Gjirokastrë, por pasi nuk e lejuan të shkonte në Tiranë, nuk pranoi të lëvizte nga Rrësheni. Ndërroi jetë më 13 gusht 1983. Më 1991 familjarët e saj e zhvarrosën, tani e ka varrin në Shish-Tufinë.

## 80-VJETORI

Për një prej formacioneve më të mëdha e më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare

# Brigada e VIII-të S shkroi me gjak triumfin ndaj fashizmit

Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në panteonin e kombit shqiptar

Tetëdhjetë vjet më pare, më 25 Prill 1944, në një lëndinë të rrethuar me lisa, me një bukuri të rrallë natyrore, në Sheper të Zagorisë u formua Brigada e VIII-të Sulmuese. Fillimisht ajo pati një efektiv prej 950 partizanë të ardhur nga njësitë partizane të Grupit të parë të Kurveleshit, Çeta “Koto Haxhi”, Batalioni “Misto Mame”, Batalioni “Thanas Ziko” e të tjerë partizanë nga Qarku i Gjirokastrës, që të gjithë të sprovuar në luftime kundër armikut. Me krijimin e Brigadës u formuan katër batalione me nga katër kompani, me një efektiv prej rreth 200-250 vetë.

Komandant Brigade u caktua Asaf Dragodi, Zv/Komandant Koço Gjeci, Komisar Qazim Kondi dhe Zv/Komisar Rrahman Parllaku. Njëkohësisht u caktuan edhe komandantët e batalioneve e të kompanive. Brenda tre mujash nga krijimi Brigada arriti të kishte një efektiv prej 820 partizanë e partizane.

Operacioni i Qershorit 1944 ishte prova më e vështirë, por edhe kalitja vendimtare për Brigadën e 8-të Sulmuese. Komanda e Brigadës dhe ato të batalioneve morën të gjitha masat organizative e operative për vazhdimin e luftimeve, deri në çlirimin e plotë të vendit. Më 5 qershor 1944 forcat e Brigadës së 8-të i zunë pritë një kollone gjermane me mbi 900 vetë që vinin nga Greqia. Luftimet u zhvilluan të ashpra në Skore, Sopik e Çatister nga Batalioni i 3-të që ishte në rrezik rrethimi. Një trimëri të rrallë tregoi skuadërkomandanti Ormen Boro, i cili me automatik e bomba dore u hodh si rrufe në llogoren e armikut në Sopik, duke asgjësuar një mitraloz të rëndë dhe duke vrarë disa gjermanë. Pas përleshjesh të ashpra ai u vra edhe vetë duke mbetur përjetë në altarin e lirisë.

Në këtë situatë armiku pësoi çoroditje, ndërsa forcat partizane po përparonin dukshëm. Nga luftimet e suk-

sesshme të forcave të Batalionit të 3-të dhe të kompanisë së 2-të në Skore, armiku u detyrua të tërhiqej, duke lënë në fushën e betejës 11 gjermanë të vrarë. Nga radhët e partizanëve u vranë 5 veta dhe u plagos komandanti i kompanisë së 2-të Mustafa Demiri.

Më 13 qershor ’44 Batalioni i 3-të sulmoi në befasi një njësi armike në Grykën e Këlcyrës, në kohën kur ishin duke ndarë dhe ngrënë darkën. Armiku i çoroditur e në panik la në këtë luftim të papritur mjaftë të vrarë e të plagosur, ndërsa nga ana jonë nuk pati dëmtime. I tërbuar nga humbjet e njëpasnjëshme, armiku kundërsulmoi forcat e Brigadës së 8-të me forca të shumta nga Gjirokastra. Prej datës 17-26 qershor 1944 për afro dhjetë ditë u zhvilluan luftime të ashpra në Lunxhëri, Çajup, Pogon e Zagori. Në kodrat e Çajupit ra mitralieri trim nga Mallakastra, Imer Xhaferi dhe u plagos partizania Keno Çarçani. Në këto luftime, Brigada bëri një tërheqje taktike në malin e Dhëmbelit. Atje u riorganizua dhe më 30.06.1944 sulmoi përsëri gjermanët në Zagorie, të cilët u detyruan të tërhiqen në Gjirokastrë, duke lënë mbi 20 të vrarë e të plagosur.

Më 19.7.44 Brigada sulmoi sërish armikun në Gjirokastrë. Batalioni i 3-të sulmoi natën në befasi duke i shkaktuar armikut humbje të shumta në njerëz e mjete, ndërsa nga forcat partizane ra heroikisht zv/komisari i kompanisë Hito Gaçe dhe u plagos partizani Ollav Dhame.

Në Gusht ’44 Brigada e 8-të mori urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për të çliruar Konispolin. Luftimet u zhvilluan të ashpra dhe pas 48 orësh (më 28 gusht ’44) Konispoli u çlirua. Armiku la më se 10 të vrarë, dhjetra të plagosur; U zunë 21 robër, mbi 17 pushkë e dy mitralozë të lehtë. Ndërkohë u



plagos skuadërkomandanti Fejzo Rexhepi nga Mallakastra, u vranë katër partizanë, ndër të cilët edhe komandanti trim i Kompanisë së 3-të Razo Zeneli. Kjo brigadë ka luftuar për çlirimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kufijve administrativë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të madh edhe në çlirimin e viseve kosovare.

Pas çlirimit të Tiranës, Brigada e 8-të S, me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm marshoi së bashku me forcat e Brigadës së 6-të në tokat e ish-Jugosllavisë, në ndjekje të pushtuesit. Gjatë luftimeve të atjeshme ranë heroikisht Heroi i Popullit Thidhori Mastora dhe komisari trim i batalionit të 3-të, Pano Xhixho.

Brigada e 8-të Sulmuese ka lënë në fushën e luftimeve kundër armikut 148 dëshmorë dhe rreth 176 të plagosur, nga këto tre shoqe partizane.

Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në panteonin e kombit shqiptar.

## 105 VJETORI I LINDJES

*Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur*

# RRAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË

**Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve. Jeta dhe vepra e tij flet më fort se mijëra fjalë.**

## HALIL RAMA

**P**ara dhjetë vitesh, kur me bashkautor Sakip Camin shkruam dhe botuam monografinë "Rahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e dy kohëve", shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço (në parathënie) do të shprehej se nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të qe një grishje për fantazinë.

Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e heroit të librit, që jetoi mbi një shekull, dhe që si rrallëkush deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri përgjithmonë (më 15 shtator 2019), mbarte dhe frymëzonte, me freskinë fizike, me mprehtësinë e gjykimit, me fjalën që nuk i binte përdhë, me gjallërinë dhe energjinë e një burri shteti... Nga jeta e një Matuzalemi si Ai, na ulet këmbëkryq historia.

Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur. Nga ëndrra e tij dhe e brezit të tij për një shoqëri të njerëzve të barabartë, që e kërkoi atë nëpërmjet komunizmit si ideologji, vjen edhe zhgënjimi i madh prej kësaj utopie që u përpoq të imponohej nëpërmjet luftës së klasave. Nga një çerek shekulli i dënimit të tij, nga plumbi dhe vdekjet në qelitë e burgut, mund të njohim një nga pamjet më makabre të dhunës së diktaturës. Nga veprimtaria si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë bashkë me të tjerë ish-të dënuar si L.Belishova, E.Ohri, H.Ramohito etj., mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Prej jetës së këtij njeriu, vijnë e të zgjohen edhe disa ndjenja, në dukje tepër intime, por që janë në thelbin e moralit të individit. Një prej tyre është dashuria dhe lidhja e tij me vendlindjen, me krahinën e Lumës dhe Kosovën. Historia dhe luftërat e tyre. Rrethanat ia sollën Parllakut që të punonte në zanatin ëmbëltues të hallvës. Tregtarët ambulante të saj në Korçë e quanin "gegë". Ky "gegë" shtathedhur, i fortë fizikisht, i pashëm që bridhte deri në Selanik, do të bëhej një nga drejtuesit kryesorë të njësiteve guerile, pikërisht në Vlorë, aty ku ishte ndezur një nga vatrave kryesore të luftës antifashiste. Megjithatë, identiteti i tij



mbetet i derdhur që nga fëmijëria, aty ku për vite të tëra ndarjeje bashkohen verilindja shqiptare me Kosovën shqiptare, me Kosovën, liria e së cilës ishte "Ëndrra e jetës së tij". Dashuria për vendlindjen është një nga ndjenjat më të bukura. Kush e shpërfill, dëshmon për një shpirt të varfër.

Jeta, lidhja me vendlindjen është zanafilla e respektit të tij për njeriun e thjeshtë, e humanizmit dhe e altruizmit. Kur më dha një mendim për librin e tij në dorëshkrim "Mirënjohje familjeve vlonjate...", i thashë se ndoshta iu kishte lënë më shumë vend nënave dhe grave vlonjate, në raport me ngjarjet e tjera të njësitit gueril. -Përkundrazi, ju kam lënë pak, - më tha. Pa dyert e zemrat e tyre të hapura, ne s'do të mund të bënim asgjë", - shkruan T.Laço.

Këtë modesti dhe altruizëm në raportin e veprës së tij në luftë dhe më pas, unë kam pasur mundësinë ta vërej dhe ta çmoj që nga takimi dhe biseda ime e parë me të rreth tri dekada të shkuara, kur bashkë me Liri Belishovën, Edip Ohri dhe Skënder Malindin më besuan drejtimin e gazetës "Veterani" që u bë zëdhënëse OBVL dhe në të cilën ata kontribuan me mendimin e tyre progresist, duke pasqyruar realisht fakte dhe ngjarje të LANÇ të shtrembëruara nga historiografia e kohës së diktaturës", shkruan Laço në parathënie të librit "Rahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e dy kohëve", që u botua me rastin e 95-vjetorit të

**Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht. Ne nderohemi me gjeneral Parllakun – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, pasi, në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim**



ditëlindjes së Heroit të Popullit, i cili po në këtë ditëlindje jubilarë u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "NDERI I KOMBIT".

## JETA DHE VEPRJA E TIJ FLET MË FORT SE MIJËRA FJALË

Do të mjaftonte qoftë edhe vlerësimi i shkrimtarit, politikanit e politologut Laço për të konkluduar në pavdekësinë e gjeneralit që bëri epokë, si legjendë në kufirin e jo dy, por tri kohëve. Këtë 17 prill mbushen 105 vjet nga ditëlindja e Rahman Parllakut - gjeneralit që bëri epokë.

Pesë vjet më parë atij ju festua me madhështi 100-vjetori i lindjes në një ceremoni solemne në selinë e Presidencës së Republikës dhe në një takim madhështor në Hotel Tirana International.

Në takimin e zhvilluar me veteranë të luftës, ish- Presidenti Meta u shpreh se "miku ynë, Rahman Parllaku, është i veçantë jo vetëm për moshën 100-vjeçare, por sepse si shumë rrallë tjetër në udhëtimin e tij shekullor i ka jetuar të gjitha: mjerimin, varfërinë, luftën, paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm të regjimit totalitar. Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht".

Si President i Republikës, Meta e konsideroi një rast fatlum dhe unik, krejt të veçantë dhe emocionues padyshim, që në selinë e Presidentit të Republikës organizonte kremtimin e një jubileu të artë, të 100-vjetorit të lindjes së Heroit të gjallë Rahman Parllaku.

"Festojmë 100-vjetorin e partizanit

fitimtar, të komandantit dhe gjeneralit, por edhe të mbijetuarit të një brezi sakrificash e privacionesh të jashtëzakonshme, që na vjen sot si dëshmitar me një shekull jetë, si monument i thënies lapidar: "Rrno për me treguel". Sot, ju Gjeneral Parllaku mbushni plot një shekull, një jetë e lavdishme në tri epoka; partizan dhe komandant legjendar antifashist; qëndrestar i burgjeve komuniste, si dhe një veteran me 'arsye dhe zë të kthjellët' në mbështetje të demokratizimit të vendit pas viteve 1990", tha ndër të tjera para 5 vitesh ish-Presidenti Meta.

I ngjizur në urtinë e odave lumjane dhe i burrëruar në Labëri, përgjatë 100 viteve Rahman Parllaku mbeti "dëshmitar i gjallë" për të gjitha ngjarjet e një shekulli.

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot.

Rahman Parllaku, ishte dhe mbetet i veçantë jo vetëm për 100 vitet që jetoi, por sepse si shumë rrallë tjetër në udhëtimin e tij shekullor i ka jetuar të gjitha: mjerimin, varfërinë, luftën, paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm të regjimit totalitar. Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht. Ne nderohemi me gjeneral Parllakun – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, pasi, në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të

(Vijon në faqen 5)

## OPINION

## BRAKTISJA E FRIKSHME E MALËSISË



të bashkive të sotme, të cilat i përqëndruan investimet atje ku deshën, ku ato u jepnin më tepër leverdi ndoshta edhe për të mbushur xhepat...Mungesa e investimeve stragjike për një jetësim afatgjatë të tyre edhe në zonat më të largëta çoi deri këtu...

Zona e Katër Grykëve në Dibër është një ndër zonat e largëta të kësaj bashkie, një zonë e njohur për atdhetarizmin e saj, mikpritjen e bujarinë që e trashëgon prej genit stërgjiyhor (fisi Ndregjoni i përmendur për strehimin e hebrevje), një zonë që ka luftuar kundër pushtuesit të huaj me dëshmorët e saj (Molla Bajram Buci u vra bashkë me të birin në betejën e Petrinjës kundër

pushtuesve serbë) dhe të figurave të tjera, si: Molla Limani, Tafë Kaziu, Sefer Bodini, Llan Destan Ndregjoni, Ismail Nika, Halil Daçi, Xhafer, Shaban e Lam Bruçi. Ajo është vendlindja e diplomatëve Bashkim Rama e Ahmet Lala, e shkrimtarëve Hysni Bruçi e Hysen Der-vishi, e për të vijuar me emra të tjerë si: Faik Bruçi, Latif Miha, Hysni Bodini, Osman Hidër Miha, Luan cemenja, Fiqiri Musa, Lazim Bardhi, Xhemal Delishi, Rexhep Rama, Bajram e Agim Totraku, Petrit e Xhetan Ndregjoni etj), një zonë që para viteve 90 kishte me mijëra banorë, ndërsa sot mezi numëron disa shtëpi. Vitet e demokracisë sollën ethet e vetshpërnguljes nga këto zona me resurse

ekonomike – pyjore - ujore dhe turistike. Kjo zonë ka 11 liqene të Kacnisë që janë të vendosura shkallë - shkallë me bukuritë e Trethit, të Shleskut të Madh, me Grykën e Vanasit, Valin, Benën etj.

Ndërsa po të hedhësh sytë e të vështrorsh të kësaj zonë shikon pyje të prera, mungesë rrugësh ose rrugë gropa-gropa ku nuk bëhet asnjë investim në to, të paktën për mirëmbajtje.

Ky shkrim i një analize më tepër përmbledhëse,ka më shumë qëllim sensibilizues, ndonëse sot çdo thirrje bie në vesh të shurdhër të pushtetarëve, ai nuk synon të paraqesë edhe pse e ka këtë verdikt, por të kumtojë një realitet që është i mundshëm të ndryshohet. Këtu nuk flasim për disa individë që kanë bërë ndonjë investim të vogël dhe që nuk mund të bëjnë investimet e mëdha. Rruga e ndërtuar në vitet 1939-1940 nga Italia është po ajo, madje më keq dhe të flasësh këtu se katërgrykasit janë kontribues në ekonominë zonale e kombëtare nuk është pak, as të sjellim në retrospektivë atë çfarë bëri sistemi i dikurshëm me mbajtjen e njerëzve këtu, libraritë, vatrat e kulturës, qendrat shëndetësore e të tjera mundësi që dha për një zhvillim infrastrukturor kulturor, kjo nuk është një çështje nostalgjie as thirrje për rikthim...Por, malësia me resurset e saj i ka të gjitha mundësitë, se ajo ka mbajtur me mijëra banorë, me pyjet, ujërat, arat, minierat, blegtorinë e pasur me të gjitha të mirat që ia ka falur natyra...Veçse braktisja e frikshme e malësisë është një kampion alarmi jo vetëm për banorët e paktë që jetojnë akoma atje si më qendrestarë për ta mbajtur malësinë në këmbë, por edhe për kombin, për vendin tonë të begatë...



Nga MEVLUD BUCI

Përveç realitetit të frikshëm të qendrave urbane, të cilat zbrazen në mënyrë të heshtur, gati pa u diktuar, zbrazja e malësisë prej njerëzve, është më e prekshme, më konkrete. Nëse udhëton sot nëpër malësi, shikon kulla të braktisura, ara të pambjella ,pemë të rrënuara nga mungesa e kujdesit, pyje të reja të mbira e të rritura nga mungesa e dëmtimit prej bagë-tive dhe dorës së njeriut. E dhimbshme është të shikosh shkolla afër mbylljes, pa folur këtu për institucione të tjera të kujdesit shëndetësor.

Janë një sërë faktorësh që kanë çuar deri këtu, të cilat merren me mend nga kushdo, po ndërsa duhet të gjykojmë për to, duhet përmendur ai që është faktori kryesor: mungesa e vëmendjes së shtetit, të komunave të dikurshme e

## RAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË

(Vijon nga faqja 4)

malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim. Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve. Jeta dhe vepra e tij flet më fort se mijëra fjalë.

### GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU "SIMBOL I QYTETIT TË TIRANËS"

Në 100 Ai i jetoi dhe përballoi me dinjitet kohën e monarkisë, të Luftës së Dytë Botërore e të sistemit monist si dhe tri dekada të demokracisë. Si një protagonist me një jetë të jashtëzakonshme, gjeneral-lejtnant Rrahman Parllaku (Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit), na provoi se ndonëse në kohën tonë moderne të globalizmit nuk bëhet fjalë për legjenda, ato ekzistojnë, pavarësisht heshtjes dhe indiferencës së opinionit publik. Emri i tij, me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.137, datë 05.10.2020, është përjetësuar në segmentin rrugor që bashkon rrugën "Ali Demi" me rrugën "Petro Nini Luarasi" (Rruga "Gjeneral Parllaku", e cila pritet të përurohet pas disa ditësh.

Kështu, duke konsideruar kërkesën e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), kryebashkiaku Veliaj i propozoi Këshillit Bashkiak përjetësimin e emrit dhe veprës së ish-kryetarit të OBVL së, gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, në një nga rrugët kryesore të lagjes ku Ai kishte banuar, deri në largimin për në botën e përtejme, tre vjet gjysmë më parë. (ceremonia e lamtumirës

një ditë pas vdekjes, më 16 shtator 2019). pESë vjet më parë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin "Simbol i qytetit të Tiranës".

Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e "Heroit të Popullit" dhe "Nderit të Kombit", që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë.

### BURIM FRYMËZIMI PËR BREZAT

Gjeneral Parllaku ishte dhe mbetet burim frymëzimi për brezat. Ai me përkushtim të rrallë e drejtoi organizatën tonë mbarëkombëtare për dy dekada dhe përkushtimi i tij bëri që OBVL të anëtarësohet në Federatën Botërore të Veteranëve.Kontributi i tij në organizimin e drejtimin e LANÇ e të Ushtrisë Shqiptare e rendit gjeneral Parllakun në krye të plejadës së gjeneralëve shqiptarë që bënë epokë.

Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.Ish-i burgosuri politik i regjimit komunist, i cili pasi doli nga burgu pas 17 vitesh vuajtje ne burgun e Burrelit, nuk u pajtua me amnistinë, por e kërkoi të drejtën në Gjykatën e Kasacionit nga ku fitoi pafajësinë. Dhe pikërisht gjenerali legjendë që gjatë viteve të burgut kishte lexuar dhe konspektuar 96 libra, letërsi shqipe



dhe botërore, u la testament brezave tre librat e tij me kujtime: "Mirënjohje familjeve vlonjate që më pritën si birin e tyre", "Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime" dhe "Memoria historike e kombit".

### HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut, atë e për-

(Vijon në faqen 13)

124 VJETORI I LINDJES

# SEJFULLA MALESHOVA, POLITIKAN, BURRË SHTETI DHE NJERI I LETRAVE SHQIPTARE

• *Me Sejfulla Malëshovën historia dhe njeriu qëndron në unison. Këtu, për hir të së vërtetës, ai historisë i dha emër, ajo ia çmoi personalitetin dhe veprën e tij shumëplanëshe. Në veprimtarinë shoqërore ai erdhi si intelektual i kompletuar dhe pikërisht ky tipar dallues, në veçanti pas luftës antifashiste, u bë "gjykimi" i tij.*



## DAUT HOXHA

**H**istoria e një populli dhe një kombi në kapërcyellin e përvjetorëve s'ka se si të mos nderojë dhe respektojë bijtë dhe bijat e tij, të cilët me vlerat njerëzore, intelektuale dhe patriotike i shërbyen asaj duke u bërë njëherazi objekt dhe subjekt i vetë historisë.

Në plejadën e kësaj gjenerate, në veçanti në historinë e re e moderne, do të kujtojmë një politikan, burrë shteti dhe njëherazi i letrave, që dha gjithçka për fitoren e luftës antifashiste të popullit tonë, e cila e renditi atë në Aleancën Antifashiste Botërore të Luftës së Dytë Botërore. (Deklarata e 12 Dhjetorit 1942).

Ky njeri, ky mendimtar, është Sejfulla Malëshova (Malëshovë, 2 mars 1900 - Fier, 11 qershor 1971), që në këtë vit i kujtojmë 124 vjetorin e lindjes. 50 vjet mbeti i harruar nën trysinë e diktaturës, 38 vjet, i persekutuar, i denigruar dhe i masakruar shpirtërisht dhe fizikisht, vdiq si militanti i mendimit dhe i veprimit socialdemokrat Sejfulla Malëshova, alias Lame Kodra. Njeriu dhe historia gjithmonë kanë jetuar së bashku, i pari është objekti dhe subjekti i saj. Nëse njeriu bën historinë, ajo bëhet gjykatësi i tij. Kjo në funksion të veprës, të qëndrimit të tij në raport me detyrën dhe përgjegjësinë që mbart, i ngarkuar dhe njëherazi në drejtim të përkushtimit ndaj tyre. Me Sejfulla Malëshovën historia dhe njeriu qëndron në unison. Këtu, për hir të së vërtetës, ai historisë i dha emër, ajo ia çmoi personalitetin dhe veprën e tij shumëplanëshe. Në veprimtarinë shoqërore ai erdhi si intelektual i kompletuar dhe pikërisht ky tipar dallues, në veçanti pas luftës antifashiste, u bë "gjykimi" i tij. Si personalitet shumëplanësh tek ai dallojmë disa drejtime.

**Së pari**, ai bëri emër në fushën e letrave, u dallua si poet dhe prozator. Ishte njohës i disa gjuhëve perëndimore dhe lindore. Vepra e tij letrare qe fshikullimë, si e gjithë letërsia e shkruar përparimtare e viteve '30, e despotizmit dhe obskurantizmit të kohës.

**Së dyti**, ai ishte mendimtar, në mendimet e tij kishte si bazë iluminizmin, ëndrrat dhe shpresat e rilindasve tanë. Në këtë plan ai dallohej si patriot demokrat, ishte për një ekonomi shumëdegëshe tregu me bazë sociale.

Me përmbysjen e qeverisë së Nolit, si gjithë ithtarët e saj, edhe Sejfulla Malëshova mori rrugën e kurbetit. U vendos në Bari, më vonë në Moskë, ku vazhdoi studimet, fitoi tituj shkencorë dhe u dallua si pedagog i doktrinës. Si i tillë, ai diti ta orientojë drejt dhe mirë veten dhe dha një ndihmesë në orientimin socialdemokrat të grupit shqiptar për inkonsequencat e zbatimit të "teorisë proletare". Këtu ai u bë ideatori për të nisur një lëvizje të mirëfilltë socialdemokrate, pikërisht në këtë kohë ai do të lëvizë në vendet perëndimore e qendrore për ta zgjuar dhe kompaktësuar këtë ide. Në këtë kohë fillon bashkëpunimin me organe si "Liria Kombëtare", "Populli" dhe "Sazani". Këtu u gjend në mesin e një grupi intelektualësh të kompletuar si Omer Nishani, Halim Xhelo, Llazar Fundo e të tjerë, me të cilët debatoi dhe propagandoi idetë e socializmit demokratik. Është koha kur ai i përgjigjet përpjekjeve të Musine Kokalarit, Gjergj



Kokoshit e Skënder Muços për të organizuar një organizatë socialdemokrate në Shqipëri.

Koha dhe historia precipituan me shpejtësi, fillimi i luftës së dytë botërore dhe pushtimi fashist i Shqipërisë para patriotëve demokratë shtroi detyra të reja. Detyra e parë kthimi në atdhe dhe fillimi i rezistencës kundër pushtuesit nazifashist.

Lufta antifashiste nisi si fillim me dëshirën spontane të patriotëve demokratë e nacionalistë, çka më vonë solli që në këtë rrafsh u përvijuan dy rryma, njera "rryma nacionaliste", tjetra "lëvizja antifashiste partiake" e drejtuar nga PKS, e cila s'e kishte bërë ende vitin e themelimit dhe në drejtimin e saj të parë mbizotëronte elementi me pikëpamje socialdemokrate, por në rrethana të caktuara historike në krye të saj dolën elementë antikombëtarë dhe antisocialistë të cilët që në fillim goditën elementin demokratik dhe patriot me moton e zbulimeve të "armiqve" dhe "grupeve antiparti".

Në këto rrethana Sejfulla Malëshova kthehet në atdhe dhe vihet totalisht në shërbim të luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Është qëndrimi i tij për të ndjekur dhe zbatuar një politikë kombëtare dhe demokratike duke patur në themel platformën politike të Konferencës së Pezës. Është ky qëndrim që në kulisat e errëta të kësaj lufte do t'i përgatiste fundin tragjik atij dhe shokëve të tij. Kështu, duke u nisur me mendime dhe qëllime të mira në shërbim të luftës, së bashku me Nako Spiro, Mustafa Gjinishi, Ymer Dishnica, Shefqet Beja, Ramadan Çitaku, Gjini Marku e të tjerë, proklamoni dhe rekomandonin materialet dhe dokumentat themeluese të PKS dhe të konferencës së Pezës që bënin fjalë dhe ishin pika referimi për të ardhmen politike të vendit pas luftës.

Shqipëria të ishte republikë parlamentare dhe të pastroheshin -izmat sllavokomuniste. Këto qëndrime dhe kërkesa ranë ndesh me pjesën tjetër të udhëheqjes, gjë që çuan në fundin e luftës në Plenumin e Dytë, datë 23 - 27 Nëntor 1944. Këtu Sejfulla Malëshova do të niste kalvarin e jetesës së tij nga diktatura dhe diktatori. Në këtë plenum ai mbrojti pikëpamjet patriotike dhe demokratike që karakterizonin luftën antifashiste të popullit tonë dhe dënoi qëndrimet sektare dhe arriviste të shfaqura gjatë luftës ndaj forcave e grupeve të ndryshme të shoqërisë shqiptare.

Në këto kushte ai ka ditur të kombinojë dhe të përshtrahë tre elementë të kohës: historinë, patriotizmin dhe politikën, falë kompletimit të tij si intelektual i dimensioneve të mëdha.

## Nga kjo dolën disa përfundime:

**Së pari** ai dallon e del sipëran mbi grupet e klanet.

**Së dyti**, përcaktoi drejt raportin e rrezikshmërisë ndërmjet klaneve dhe grupeve.

**Së treti**, ai nuk kërkonte të mbulohej apo renditej pas njëshit apo lidërshiptit.

Dy gjëra nuk do t'i harronte krahas të tjerave, për të cilat e rëndoi dhe bëri çmos që ta asgjësonte diktatura dhe diktatori. Së pari formimin e tij si intelektual, si njeri i letrave dhe përpjekjet e tij për një kulturë kombëtare, mbështetur në traditën, larg realizmit socialist dhe me orientim bashkëkohor.

**E parë** në këtë plan, si gjatë Luftës Antifashiste dhe pas saj, me cilesinë e ministrit të kulturës, ndihmoi dhe inkurajoi elementin e ri të talentuar në fushën e letrave dhe të krijimit, gjë që u pa e shkruar dhe në organet e kohës, si ato qendrore "Bashkimi" e "Kushtrimi i Lirisë", ashtu dhe në organet e njëjve partizane. Ajo që i rrit dimensionet e kësaj figure në fushën e organizimit dhe të politikave kombëtare për kulturën është përpjekja e bërë për organizimin e Kongresit të Parë të Shkrimtarëve Shqiptarë më 7 Tetor 1945. Në këtë Kongres u vendos themelimi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë me 74 anëtarë, kryetar i së cilës u zgjodh unanimisht Prof. Sejfulla Malëshova. Në Kongres morën pjesë dhe u bënë anëtarë të LSHA-së shkrimtarë të të gjitha rrymave dhe të mendimit për të shkruar e krijuar ndryshe. Sejfulla Malëshova ndoqi një kurs pajtues liberal politik në ekonomi, por në veçanti në fushën e kulturës dhe të krijimit me qëllimin e mirë që të inkurajonte dhe të riintegronte forcat krijuese jokomuniste në jetën shoqërore dhe në administratën shtetërore. Ai në mënyrën e vet të drejtimit dhe të hartimit të politikave kulturore kombëtare bëri të njihen dhe të ruhen vlerat e saj që ishin krijuar para dhe pas Pavarësisë, me krijimin e Shtetit Shqiptar në 28 Nëntor 1912. Në këtë plan ai dëshmoi kurajon civile dhe intransigjencën e një burri shteti për mbrojtjen e këtyre vlerave. Ai mbrojti personalitetet e letrave e të kulturës sonë si At Gjergj Fishta, Prof. Mirash Ivanaj e të tjerë. Kjo gjë nuk kaloi pa pasoja në Plenumin VI të Shkurtit 1946. Sejfulla Malëshova merr goditjen përfundimtare, duke u përjashtuar nga të gjitha institucionet drejtuese me nofkën "armik i popullit". Kjo e përshkallezuar edhe me përjashtimin e tij si kryetar i LSHA-së. Pas kësaj goditje, ai do të pësojë kalvarin e vuajtjeve dhe persekucionit politik dhe fizik në kampet e "riedukimit" dhe i veçuar e i ndaluar nga puna krijuese letrare. **Së dyti**, platformën e tij ekonomike dhe politike me orientim perëndimor, të tipit socialdemokrat, çka do ta giesh të sintetizuar në ceremoninë e përvjetorit të Bankës Kombëtare Janar 1945 - 23 Janar 1946...

Pikëpamjet e tij socialdemokrate ai do t'i shpaloste në organizimin dhe drejtimin e "Fushatës Zgjedhore për Asambleen Kushtetuese" 2 Dhjetor 1945, ku me zhërvjellteshi politike do të gjente hapësira dhe do të përkrahte forcat demokratike që kërkoniin t'i atashoheshin kësaj fushate. Njëherazi ai do të bënte thirrje për demokratizimin e legjislativonit zgjedhor. Prof. Sejfulla Malëshova kudo që shkoi në mbarë vendin për drejtimin dhe organizimin e fushatës bënte thirrje për veprime demokratike. Në një nga mitingjet e tilla në Shkodër ai shprehej: "Shkodra e demokracisë dhe e Kazazëve." Ai vdiq në verën e nxehtë të vitit 1971, që do të ishte prologu e epilogu i një vere tejet të nxehtë politike në mbarë vendin nga plenumet famëkeçe të atij dhjetëvjeçari që asgjësuan gjithçka të mirë që kishte ngelur dhe që rilulëzonte në vendin tonë.

## VLERESIME PËR SEJFULLA MALËSHOVËN - ALIAS LAME KODRA - NGA MIQ, SHOKË E BASHKËLUFTËTARË:

Dr. Ymer Dishnica: Të parafrashojë e të komentosh vjershat e Lame Kodrës është njësoj sikur të duash të

(Vijon në faqen 7)

## IN MEMORIAM

# FILLORETA FEJZO, GRUA DHE LUFTËTARE DINJITOZE

## SHPENDI TOPOLLAJ

Këto ditë u nda nga jeta pas një sëmundjeje të rëndë veterania Filloreta Fejzo. Ajo ishte lindur në vitin 1928 në fshatin Grapsh të Devollit në një familje që ishte bashkuar me rezistencën e armatosur antifashiste qysh në fillimet e saj. Vetë ajo, ende e vogël, në moshën trembëdhjetë vjeçare, mori vendimin e guximshëm për t'u rreshtuar me repartet partizane, duke u bërë pjesë e Br. XVIII - të S. Edhe pse ende e parritur, ajo u dallua për trimëri në të gjitha aksionet ku mori pjesë. Dhe duke parë vlerat e saj, pas çlirimit të vendit e caktoj në sekretare në Divizionin e Beratit me komandant Kristo Themelkon dhe komisar Tahir Kadarenë. Pas largimit të tyre në detyra të rëndësishme në Tiranë edhe ajo kërkoi ta transferonin pranë familjes. Kërkesa ju miratua dhe ajo filloi punë në të njëjtën detyrë në Divizionin e Korçës. Atje u dashurua dhe e lidhi jetën me Abaz Fejzon nga Tragjasi, njërin nga luftëtarët e shquar dhe më të kulturuar i cili aso kohe kryente detyrën e shefit të shtabit të atij Divizioni. Nuk kaloi shumë dhe pas emërimit të të shoqit atashe ushtarak pranë ambasadës tonë në Itali, ajo kalon disa kohë të paharruara në Romën e artistëve të mëdhenj. Më pas, Abazi shkon për studime në Akademinë "Frunze" në Moskë të cilën e kreu me rezultate të shkëlqyera, dhe meritoi medaljen e artë, kurse Filloreta si burrneshë rriti tri vajzat e saj Elizën, Tamarën dhe Pranverën. Filloreta, një grua dhe intelektuale dinjitoze e ndoqi të shoqin, tani gjeneral major, kudo që atë e caktonin, por në Durrës ku e emëruan Drejtoreshë të teatrit "Aleksandër Moisiu", ajo tregoi vlerat e saj të larta njerëzore dhe profesionale. Edhe sot e kësaj dite atë e kujtojnë me respektin më të madh si një drejtuese të thjeshtë, dhe shumë dashamirëse me aktorët dhe punonjësit e atij institucioni. E tillë mbeti Filloreta kudo që punoi më pas në kryeqytet, ku i shoqi qe caktuar Drejtor i Përgjithshëm i Mjeteve të Blinduara në Ministrinë e Mbrojtjes.



Ajo ka qenë drejtoreshë e Ndërmarrjes së Peliçerisë dhe Kombinatit të Mish - Qumshutit. Por kjo zgjati derisa Enver Hoxha realizoi atë "Fshesën e hekurit" në ushtri, nga e cila pa asnjë arsye e pësoi edhe Abazi dhe për pasojë, atë e internojnë në Gramsh si punëtor dhe pastaj e dënojnë bashkë me shokët e tjerë drejtues kryesorë të ushtrisë, me 20 vite burg në Burrel, atje ku dikur kishte qenë komandant i Brigadës. Në internim dërgohet edhe Filloreta, ajo partizania trembëdhjetë vjeçare, së bashku me vajzat. Në gjithë këtë situatë të trishtuar fati e rëndoj më tej gjendjen e tyre, pasi vajza e saj e dashur Tamara sëmundet me diagnozën e vargut Alpha e rëndë. Çfarë nuk bëri nëna e gjorë për ta shpëtuar atë, por qe e kotë. E bija, kur u nda nga jeta, ishte vetëm 28 vjeçe. Ky hidhërim ja coptoi zemrën nënës, që e ndoqën të tjera halle; si veç përbuzjes së nxitur nga sigurimi i shtetit dhe përjashtimit nga Partia si bashkëpunëtoreshë me burrin "puçist", e largojnë edhe nga qyteti i Gram-

shit dhe e dërgojnë me vendimin absurd të Komisionit të Dëbim - Internimeve në fshatin Bërsnik. I vendosën për të banuar në një karakatinë, ku para se të burgosej kishte jetuar në të ish truroja e Kryeministrit që e kishin vetëvararë, Ali Çeno. Këtu Filloreta Fejzon e nxorrën në pension, kurse vajzat Eliza, mjeke dhe e motra, merrnin shatat dhe shkonin gjithë ditën për prashitje arave dhe në punë të tjera të rënda. Me mendjen tek Abazi që vuante në burgun mesjetar dhe shtërngesën për t'i çuar diçka atij, me pikëllimin për humbjen e vajzës fatkeqe, Filloreta kaloi një pjesë të jetës mes vuajtjeve të mëdha shpirtërore. Lexuesit e nderuar të kësaj nekrologjie i bëj me dije se për këtë familje të respektuar, kam shkruar romanin "Luani i Kafazit" prej nga artistikisht po shkëpus letrën që Abazi i dërgon Filloretës nga burgu: "E shtrenjta Filloretë! Të gjitha i marr me mend. Ju edhe në Luver po të ishit, pikëllimi për fatin tim, do t'u mbyste. Bëhuni të forta, se jeta kështu qenka. Në këtë botë, pasuria më e madhe është nderi. Atë e kemi vetë në dorë dhe nuk mund të na e marrë askush. Lexoje edhe një herë "Odisenë" moj Reti. E di që atë libër e keni. Edhe burri i Penelopës, po njëzet vjet u largua nga Itaka. Por ajo e gjeti mënyrën që ta priste. Pëlhuara e saj mbeti në jetë të jetëve, një metaforë, për të gjitha gratë që janë të detyruara të presin kaq gjatë.

Për mua mos u shqetësoni. Jo se jam në Fushat e Elizeut, si Menelau, dhe as që pres si Danaja atë shiun e artë, (ti e pëlqeve shumë pikurën e Gustav Klimtit kur e pamë atje në Itali), por sado të zemërohet Zeusi me Prometeun që u shpërndau njerëzve zjarrin, përsëri nga kutia e Pandorës, diçka shumë e shtrenjtë për njeriun, do të mbesë. Aty ku jeni, mund të lodheni, por të paktën disi e humbni mendjen. Kurse këtu, çdo ditë dhe çdo orë më del parasysh Tamara jonë. Ajo e kishte më të rëndë se ne të gjithë: ishte e re, fare e re dhe e dinte se ç'është priste dhe përsëri buzëqeshja nuk iu nda asnjë herë. Dhe unë, u tregova më i rreptë se ç'duhej, duke mos i dhënë atë kokrrën e mollës që dikush kishte sjellë nga Korça, kur ajo më lutej. Isha bërë i drejtë si Hesperia që romakët e lashtë, ti e di, e quanin Vesperi. Madje, isha bërë si Ladoni, dragoi me shtatë kokë që ruante kopsh-tin e mollëve të arta të bijave të tij. Dhe pastaj, e përcollëm atë ditë, veshur me të bardha, pa njerëz dhe pa lule. Shpirti im e di, sesa vuaj për të. Ju keni aty njëra - tjetrën. Fatkeqësia do t'u afrojë akoma më shumë.

Po e patë se e keni të vështirë, më dërgoni më pak lekë, se unë këtu bëj si bëj. Nuk kam pasur ndonjë oreks të madh atëherë, e jo më tani që më është prerë fare". E megjithatë, Filloreta kurrë nuk u thye në krenarinë e saj dhe bindjen se asgjë të keqe nuk kishin bërë ndaj popullit e atdheut. Dhe sikur të mos mjaftonin gjithë këto, atje në burgun e tmerrshëm, pra sapo kishte mbushur 62 vjeç, vdes dhe burri i saj i shtrenjtë, gjenerali legjendar Abaz Fejzo, ai që e pajisi ushtrinë shqiptare me qindra e qindra tanke të reja. Fjalët e tij të fundit sipas romanit, ishin: "Më fal o Zot! Unë nuk të besova, por të keqen nuk e pata nga ti. Të keqen e pata nga ai që ishte një horr dhe ne besonim se ishte Zot". Dhe si përherë për raste të tilla, varrimi pa praninë e familjes atje te Qershia. U desh ardhja e demokracisë që Filloreta, me të bijën Eliza, etj. dhe Heroin e Popullit Rrahman Parllaku me Gjergj Titanin të shkonin e ta shvarrosnin. Ishte në gropë pranë gjeneralit tjetër Vaskë Gjinos, që si shumë të tjerë u bënë fli për tekat e një panarojaku, duke u shkaktuar mjerime edhe familjeve të tyre. Pavarësisht se ato nuk e ulën kokën asnjëherë. Dhe shembulli më domethënës për këtë është jeta e papërlyer e luftëtares, bashkëshortes, nënës dhe intelektuales së mrekullueshme Filloreta Fejzo.

## SEJFULLA MALESHOVA, POLITIKAN, BURRE SHTETI DHE NJERI I LETRAVE SHQIPTARE

### (Vijon nga faqja 6)

belbëzosh e të thuash keq ato që janë thënë me akcen bilbili ...

Gjuha në tosk ishte shtruar e të kulluar, në traditën e Naimit e të Çajupit, të Faikut e të Fan Nolit... Vjersha e punuar me mjeshtri të rallë, e pasur me muzikalitet, në harmoni, me ritëm, me rimë të pasur... Pak janë ata bijë të këtij populli që kanë dhënë një kontribut aq të çmuar për ndritjen dhe ndërtimin, për konsolidimin dhe për frymën e Shqipërisë së re. Shkrimtari, poeti rebel është një i pandarë me personalitetin politik të shquar, anëtar me rëndësi në gjirin e qeverisë demokratike. Lame Kodra është mishërimi i luftës dhe i përpjekjeve për liri dhe për demokraci që ka bërë dhe bën populli shqiptar.

**LAME KODRA** qan e qesh me popullin, këndon e lufton për popullin, shpreson e fiton me popullin, del në dritë me popullin. Populli është sot në tribunën e Shqipërisë, Lame Kodra është sot poeti ynë kombëtar, poeti i Shqipërisë së re demokratike.

*Nga parathënia e librit "Vjersha", viti 1945*

**Pashko Gjeçi:** Lame Kodra është një poet konceptesh. Bërthama e veprës së tij është mendimi, ideja. Dhe ideja vë në lëvizje krejt botën e fantazisë së

tij. Tek Lame Kodra nuk mund të ndash idenë prej trajtës. Ndër poezitë e tija, nënkuptohet, në ato më të bukurat, nuk ka zona të errta. Krejt bota poetike e tij është përpirë nga një dritë e fuqishme. Poeti është revolucionar në shpirt, por revolucionar i lidhur ngushtë me traditën e shëndosha shqiptare. Fryn erë shqiptare ndër poezitë e Lame Kodrës, si ajo frymë dhe ndër poezitë më të frymëzuara të Fishtës, të Naimit, të Nolit. Lame Kodra është trangu shqiptar. Lame Kodra është shqiptar i lirë e përparimdashës. Patriotizmi i tij ka një përmbajtje e stil të ri.

*"Bota e Re" nr. 4, Tetor 1945*

**Dr. Selaudin Toto:** Lame Kodra është poet kryengritës. Fuqinë e fjalës ai e ndjen më mirë në veprim. Arti për të ka lidhje dinamike me jetën e përpjekjen. Në çastet më tragjike për vendin tonë ai merr armët dhe del të luftoj në mal për liri. Në luftë e sipër ai shkruan poezi. Lame Kodra është poeti i lëvizjes nacional-çlirimtare dhe në këtë pikëpamje lidhet drejtpërdrejt me traditën e shkrimtarëve tanë të Rilindjes. Në është se Naimi, Fishta, Noli ose Konica mundën të ngjallin me punën e tyre krijuese ndjenjën e kombësinë, ky, duke vazhduar në këto gjurmë, bëhet shprehës i fuqishëm i përpjekjeve të popullit për liri e demokraci.

*"Bota e Re" nr. 6, Dhjetor 1945*

## OPINION

# DIALOGU KOSOVË-SERBI ENDE NË “QORRSOKAK”



**Nga Bashkim Hisari**

Kanë kaluar afro tre dekada dhe Serbia pothuaj fare nuk ka lëvizur nga vendi sa i përket qëndrimit ndaj Kosovës dhe dialogut për normalizimin e raporteve ndërshtetërore. Vazhdon të funksionojë një simbiozë sistematike e politikës, krimit, policisë, biznesit, mediave. Në këtë pushtet mafioz gjithçka është e mundur. Dikur ishte Slobodan Miloševići, tani janë Aleksandar Vučić, Ana Brnabić, Ivica Dačić, Aleksandar Vulin, dikur bashkëpunorë, tani ndjekës të denjë të ideve të tija kriminale. Qytetarët janë të zemëruar. Pushteti autoritar mbrohet me kordona policor, me votat e vjedhura të qytetarëve, represione, gënjeshtër, me mafiozë që po përhapin të keqen.

Nuk respektohen të drejtat e qytetarëve, as marrëveshjet e arritura me Kosovën. Nuk e njohin realitetin e Kosovës dhe karshi këtij realiteti, bëhen të shurdhër e të verbër. Ndaj marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë janë në një gjendje thellësisht të ngjirë. Rreth dhjetë vite dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, nuk po prodhon rezultate të pritura, kurse tensionet nuk po zbuten. Veprimet e njëanshme po ndikojnë negativisht në ndryshimin e gjendjes, marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve nuk janë të mira. Armiqësia mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve është e madhe. Nuk ka vullnet për pajtim për t'u përballur me të kaluarën. Nuk ka shenja se ndonjëra prej palëve po mendon seriozisht për normalizimin e raorteve. Të dyja qeveritë kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre qasje përjashtuese. Serbia ende shpreson që ta rimarrë Kosovën dhe këto shpresa janë të përqëndruara në Veri, në pjesën e banuar me shumicë serbe.

Në historinë e serbëve, me dekada ka pasur edhe disa veçori në zbatimin e një politike të prirur për të ushtruar dhunën më të egër për shfarosjen e plotë të shqiptarëve. Shumë veprime të tyre kanë qenë të ngjashme me ato që



përafrohen me qeverisjen e nazi-fashizmit. Në luftërat që i zhvilluan duke bërë krime më monstruoze, që drejtoreshin nga nacionalizmi ekstrem, hegjemonizmi dhe paradigma e tyre se “serbët ishin fitues në luftë dhe humbës në paqe”, doli dëshmuar se për serbët, territori është më i rëndësishëm se çdo gjë tjetër. Krerët politikë dhe pjesa mbizotëruese e elitës intelektuale serbe, kurrë nuk kanë qenë të kënaqur me territorin e shtetit të tyre të cilin janë përpjekur të zgjerojnë në kurriz të shqiptarëve. Drejtësia, paqja, respektimi dhe bashkëpunimi me fqinjët, hapja ndaj botës - asnjëherë nuk kanë qenë prioritet për ta. Përkundërazi, kapërcimi i rrugës drejt perëndimit, orientimi drejt Rusisë, mospranimi i sundimit të ligjit e kulturës pluraliste politike, shtypja e lirisë, të drejtave të njeriut dhe miti mbi Kosovën, pa ndërprerje kanë dominuar në mënyrën e të menduarit politik të serbëve.

Këto karakteristika janë evidente edhe tani kur Serbia nuk po implementon marrëveshjet për normalizimin e marrëdhënies me Kosovën. Nuk po e përshtat politikën e jashtme me atë të BE-së. Është vendi i vetëm evropian që nuk ka miratuar sanksione kundër Rusisë pas agresionit kundër Ukrainës. Serbia është vendi ku bëhet mohimi i krimeve, glorifikimi sistematik i kriminelëve të dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale në Hagë për krimet e kryera gjatë luftërave të përgjakshme në ish Jugosllavi, ku u vranë rreth 130 mijë njerëz në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Slloveni.

Autoritetet Serbe vazhdojnë të shkelin integritetin territorial të Kosovës. Nuk e njohin subjektivitetin ndërkombëtar dhe parimin e barazisë së palëve. Kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare

duke përdorur edhe dhunën në marrëdhëniet ndërshtetërore. Kosovën e konsiderojnë pjesë e territorit të tyre dhe shtetin sovran e të pavarur të Kosovës e quajnë shtet i rremë dhe terrorist

Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, ata trimërojnë, nxisin dhe financiarisht mbështesin strukturat ilegale që operojnë në territorin e Kosovës si “Mbrotjtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”, që ushtrojnë veprimtari me qëllim të cenimit të rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës. Më 24 shtator 2023, pjestarët e tyre organizuan një sulm të armatosur në fshatin Banjskë në Veri të Kosovës. Në këtë sulm mbeti i vrarë rreshteri i policisë së Kosovës Afrim Bunjaku dhe për rrjedhojë edhe disa terroristë serbë. Në zonën e Manastirit ortodoks të këtij fshati ku ishin strehuar sulmuesit, u gjetë një sasi e konsiderueshme armatimi. Sulmi ndaj Policisë së Kosovës u cilësua si sulm terrorist dhe këto organizata, Kosova i shpalli si terroriste.

Dështimet e fundit të bisedimeve në kuadër të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, moszbatimi i marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe në Ohër që ofrojnë normalizim dhe një të ardhme më të mirë për qytetarët e të dy vendeve si dhe reagimet e zemëruara të Beogradit bashkë me shqetësimet e diplomacisë perëndimore për shkak të vendimit se euroja është valuta e vetme që mund të përdoret për pagesa të gatshme në Kosovë, dëshmojnë se në marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Beogradit nuk ka përparim dhe se janë në fund të “qorrsokakut”. Situatën edhe më shumë vazhdon ta tensionojë presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić, i cili ditë më parë deklaroi se nuk e përjashton mundësinë që Serbia të përdorë forcën në Kosovë, kërcnon Perendi-

min duke thënë se Perendimi duhet të zgjedh mes Kosovës dhe Serbisë. Nëse ata zgjedhin Kosovën, Vučić ka thënë se “Serbia do të presë momentin dhe ne do të shfrytëzojmë mundësinë tonë”.

Kosova tani më nuk është ajo që ka qenë. Pas shumë sakrificave të popullit të Kosovës, luftës çlirimtare, rezistencës shumëvjeçare dhe përkrahjes historike që ka marrë nga aleatët, ajo është shtet sovran në konsolidim.

Para 16 viteve, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Shpallja e pavarësisë ishte kurorëzim i një rrugëtimi të dhimbshëm i popullit shqiptar që vite me radhë i vuajti pasojat e spastrimit etnik nga forcat policore ushtarake serbe. Me ndjenja të fuqishme krenarie, gëzimi e kënaqësi, të gjithë qytetarët e Kosovës, festojnë këtë arritje të jashtëzakonshme politike, juridike, sociale, kulturore e qytetërore sepse Kosova u bë jo vetëm me Kushtetutë por edhe me President, Kuvendin, Qeverinë, Pushtetin gjyqësor, Gjykatën Kushtetuese, me flamurin, stemën dhe himnin shtetërore, valutën, Bankën Qendrore, Doganën, Forcat e Sigurisë, Policinë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve, Universitetin etj. Krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, komuniteteve në Kosovë u është mundësuar të gëzojnë edhe të drejta të veçanta. Atyre u janë siguruar kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë ta ruajnë, ta mbrojnë dhe ta zhvillojnë identitetin, fenë, traditat dhe kulturën e tyre. Ata kanë të drejtë të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre, të themelojnë e menaxhojnë institucionet private të arsimit. Në jetën private dhe publike lirisht të përdorin gjuhën, alfabetin, simbolet e tyre. Kanë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në media. Në Kuvendin e Kosovës, 20 prej 120 vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve. Të gjitha këto të drejta kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe serbët në Kosovë.

Por një pjesë e popullatës serbe në Kosovë përfshirë kriminelët dhe grupe paramilitare që mbështeten nga institucionet të cilat në Kosovë funksionojnë në mënyrë të jashtëligjshme, rezistojnë të shfrytëzojnë këto të drejta.

Ndërkaq, lufta për liri, vetëvendosje dhe për identitetin e pavarur të Kosovës ka pasur një traditë të gjatë dhe domethënëse. Kjo traditë lridashëse u shpreh veçanërisht në luftën kundër Perandorisë Osmane, regjimeve serbe që zaptuan trojet tona, në LANÇ, sidomos në ish Jugosllavi pas inkorporimit të Kosovës në Serbi, luftës së UÇK-së dhe popullit lridashës. Për këto ideale, Kosova dha shumë dëshmorë dhe heronj legjendarë si: Mic Sokoli, Azem Bejtë, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Emin Duraku, Fadil Hoxha, Xhavid Nimani, Veli Deva, Mahmut Bakalli, Adem Demaçi, Ibrahim Rugova, Adem Jashari e shumë të tjerë.



## BASHKËPUNIMI

Takim mirëkuptimi mes drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të LANÇ “Nderi i Kombit” dhe të OBVL

# Dy organizatat e veteranëve, bashkë në 80-vjetorin e çlirimit të atdheut

Nga Muharrem GJOKA

Nënkryetar i OBVL

**Kryesia e OBVL-së përshëndet këtë përaftrim qëndrimesh për faktin se që në deklaratën e parë pas krijimit (27 korrik 1994) kryesia e organizatës sonë do të shprehej se: “Ne duam bashkim dhe angazhohemi totalisht për arritjen e tij mbi parimet e drejta të mirëkuptimit dhe tolerancës ashtu si na takon dhe si i nevojitet Shqipërisë**



**H**artimi dhe realizimi i një programi të përbashkët veprimtarish në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë bëri bashkë drejtuesit e Organizatës së Veteranëve të LANÇ “Nderi i Kombit” dhe të OBVL. Gjatë një bashkëbisedimi të ngrohtë e miqësor, përfaqësuesit e Org.Veteranëve të LANÇ, Prof. Hulusi Hako, Sekretari i Përgjithshëm Veli Myftiri, Kryeredaktori i gazetës “Kushtrim Brezash” Bashkim Koçi dhe të OBVL: nënkryetërit Muharrem Gjoka e Maksim Vinçani dhe kryetarët e OBVL Durrës e Tiranë, përkatësisht Shpendi Topollaj dhe Mazllum Parlaku, si dhe Sekretari i Përgjithshëm Halil Rama konkluduan për pikëpjekje programore mes dy organizatave që konsistojnë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, sidomos këtë vit në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë.

Profesori i mirënjohur Hako, i cili gjatë gjithë karrierës së tij është shquar për vizionin bashkëkohor dhe si mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, e konsideron ngjarje të shënuar 30 vjetorin e OBVL në këtë vit jubilar të 80 vjetorit të çlirimit. Pasi shprehu ngushëllim për ndarjen nga jeta të kryetarit të OBVL kolonel Sotir Budina, Hako vlerësoi personalitete historike të Luftës dhe persona publikë si Dr. Ymer Dishnica, Gjeneral Rrahman Parllaku, Kolonel Myfit Guxholli në drejtimin e kësaj organizate që ka dhënë kontributin e saj të vyer në evokimin e vlerave dhe lavdisë së Epopesë së Madhe Kombëtare. Duke vlerësuar programin e OBVL për bashkim kryetarit i OVP të LANÇ “Nderi i Kombit”, Hulusi Hako tha se: “Mbetemi gjithnjë me po atë ndjeshmëri të lartë dhe besnik të patundur të parimeve të pastra ndaj realizimit të këtij imperativi historik dhe jetik.

Në këtë frymë u shpreh edhe nënkryetari i OBVL Maksim Vinçani, për faktin se jemi dy Organizata Atdhetare me të njëjtën kauzë, objektiva dhe ideale të përbashkëta. Prandaj, sipas tij, vënia në veprim e vullnetit atdhetar, përcaktimi i disa modaliteteve të thjeshta të afrimit, lidhjeve e bashkëpunimit midis të dy organizatave të LANÇ në veprimtari të përbashkëta, deri në orientimin e natyrshëm në bazë e qendër për unifikim, do të pritej si një shtesë e madh nga mbarë populli dhe krenimi i 80 vjetorit të Çlirimit të Atdheut do të bëhej sipas identitetit, vlerave e dinjitetit që i takon.

Kryesia e OBVL-së përshëndet këtë përaftrim qëndrimesh për faktin se që në deklaratën e parë pas krijimit (27 korrik 1994) kryesia e organizatës sonë do të shprehej se: “Ne duam bashkim dhe angazhohemi totalisht për arritjen e tij mbi parimet e drejta të mirëkuptimit dhe tolerancës ashtu si na takon dhe si i nevojitet Shqipërisë. Jemi të bindur se të bashkuar do të mbrojmë më mirë traditat luftarake dhe vlerat patriotike të LANÇ, që brezave t’u transmetojmë mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi ato të partive politike, se ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar”.

## KOHA PËR KOMPROMISIN E SHUMËKËRKUAR

Kjo frymë e bashkëpunimit ka mbizotëruar pothuajse në veprimtarinë e OBVL për tri dekada, që nga themelimi i saj. Kujtojmë me këtë rast se para tetë vitesh, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku, në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) u drejtoi një promemorie krerëve më të lartë të shtetit (ish-Presidentit të RSH, Bujar Nishani, ish-kryetarit të Kuvendit, Ilir

Meta, dhe Kryeministrit Edi Rama, si dhe kryetarëve të partive parlamentare, ku argumentonte domosdoshmërinë e unifikimit të qëndrimeve në funksion të integritetit euroatlantik të vendit. Apeli i gjeneralit legjendë bëhej në një kohë kur klima politike në vend ishte tejte e tensionuar.

“Në moshën time të thyer, (atëherë 97-vjeçare), përballë revanshit të nostalgjikëve të diktaturës komuniste dhe ekstremistëve pa fre të të dyja palëve, e ndjej si obligim t’ju bëj thirrje, që t’i riktheheni arsyes së shëndoshë, për të realizuar pajtimin kombëtar, aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e të gjitha kohërave”, shkruante gjeneral Parllaku në promemorien e tij para tetë vitesh.

Po ashtu, anëtarit i kryesisë së OBVL, shkrimtari i mirënjohur Shpendi Topollaj, njëherësh kryetar i Degës së OBVL të qarkut Durrës, në artikullin e botuar në gazetën “VETERANI” (nr. 3393), mars 2021, duke argumentuar domosdoshmërinë e bashk(pun)it, ndër të tjera shkruan se: “Asgjë esenciale nuk i dallon programet dhe qëndrimet e këtyre dy organizatave në çështjet kardinalë”. Po ta shohësh në retrospektivë, dhe të analizosh të gjitha fjalimet, artikujt, librat dhe intervistat e tij, gjatë gjithë kohës që OBVL-në e drejtoi Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, gjeneral Rrahman Parllaku, dhe në vazhdim të tjerët pas ndarjes së tij nga jeta, lehtësisht do të konstatohet krenaria për lavdinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe venerationi për të gjithë ata djem e vajza që trimërisht dhanë jetën për liri.

## ATDHEUN TË GJITHË E DUAM NJËSOJ

Të dyja gazetat “Veterani” dhe “Kushtrim brezash”, që këto organizata periodikisht nxjerrin apo të gjitha

veprimtaritë përkujtimore që janë zhvilluar, kanë përkujtuar e glorifikuar me të drejtë të njëjtat beteja, po ato çeta, batalione, Brigada, Divizione e Korparmata, drejtuesit e tyre dhe po ata dëshmorë e heronj.

Të dyja organizatat, Luftën Nacionalçlirimtare e konsiderojnë më të lavdishmen pas atyre të Skënderbeut dhe manifestojnë respektin dhe vlerësimin më të madh për ndihmën e dhënë nga forcat aleate dhe rolin e rëndësishëm që ata luajtën në këtë luftë. Po ashtu, të dyja këto organizata, theksojnë sakrificat e jashtëzakonshme që bëri populli ynë gjatë kësaj lufte dhe kontributin e tij në fitoren përfundimtare. ...Të dy organizatat përkrahën njëllor luftën e UÇK-së. Atdheun të gjithë e duam njësoj. Nuk duhet harruar se qysh atëherë, jnë botë, por edhe në Shqipëri ka rrjedhur shumë ujë; koha e gjatë që ka kaluar (se nuk janë pak afro tetëdhjetë vjet), ka qenë mëse e mjaftueshme, si për të krijuar sekush bindjen e tij, ashtu edhe për ta fashitur mospajtimin.

Duke i shkruar në një të vetme dy organizatat e veteranëve të Luftës, a nuk do të qe një akti i madh fisnikërie e pajtimi kombëtar, një shërbim i vyer patriotik ndaj popullit e vendit tonë të shtrenjtë, kur ai ka kaq nevojë për dashuri e mirëkuptim? Dhe për një shembull.

Synimi për bashkim është fiksuar edhe në statutin e OBVL – së dhe i ndjeri dhe njerëzori Rrahman Parllaku e ka shprehur disa herë, gjë që sot mund ta marrim edhe si një amanet të tijin....

Po në këtë frymë që edhe bashkëbisedimi në këtë takim mes drejtuesve të dy organizatave të veteranëve të LANÇ me datë 21 mars 2024, duke e konsideruar domosdoshmëri dhe imperativ të ditës realizimin e bashk(pun)mit mes tyre.

## 80-VJETORI I RËNIES

# SAMI GOLEMI BIRI I FUSHËBARDHËS

## GJAKUN E ÇIMENTOI ME LIRINË

(Në nderim të 80 vjetorit të rënies të dëshmorit të Fushëbardhë Sami Sejdi Golemi si dhe shokëve të tij të Labërisë të rënë pranë Senicës së Delvinës. Mirënjohje Këshillit Bashkiak të Delvinës që miratuan njëzëri dhe firmosën ligjërisht Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14 datë 30.3.2021, "Për miratimin e ngritjes së memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi 17 vjeç, Karafil Vehip Bello 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi 37 vjeç, Sefer Ramo Meta 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj 19 vjeç, pranë fshatit Senicë të Delvinës).



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Vitet kalojnë dhe u bënë dekada, nga rënia për atdhe e dëshmorëve të lirisë. Edhe pse kaluan tetë dekada më i lartë është nderimi, mirënjohja dhe respekti për bartësit e idealeve të lirisë, për bijtë e bijat e Labërisë dhe mbarë kombit shqiptar, që gjakun e çimentuan me lirinë. Epitetet për lartësinë e piedestaleve e memorialeve kanë bazë të fuqishme kur kujtohen e respektohen me dinjitet e krenari. Nderimi dhe mirënjohja për dëshmorët është nderim e respektim i idealeve të kombit e flamurit. Një ndër luftëtarët e lirisë gjatë LANÇ-it ishte partizani i orëve të para Sami Sejdi Golemi, që jetën ja fali atdheut me përkushtim të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare të lirisë. Ai ra trimërisht në Senicë përtej Skërficës, Luvadhit e Zagonikut. Atje ku kishte rënë edhe trimi Karafil Bello, ranë në betejë më 14 mars 1944 edhe Sami Golemi, Hasan Çerepi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj, pranë fshatit Senicë të Delvinës. Brezat e burrëruar në kohë baruti, pas luftës mbajnë në kujtesë një lapidar në formë koni si kujtesë lufte, në vendin e quajtur Qafa e Hanit, që fliste shumë për burrat që ranë për Atdheun, që gjakun e çimentuan me lirinë dhe merituan titullin e lartësuar "Dëshmor i Atdheut". Historia labe dhe jo vetëm flet qartë për trimërinë dhe lavdinë e burrërisë shqiptare, për heronjtë e dëshmorët që gjakun e dhanë me vullnet të lirë për shënjtërinë e Atdheut dhe kombit. Refreni i këngës tingëllon fuqishëm edhe aktualisht: "nëna ju kish rritur,/për një botë të re,/lule more trima,/që ratë për atdhe".

Prandaj liria e ka rrënjët thellë në gjakun e të rënëve. Për këtë arsye poeti qartëson: "...duhet të ngrenë nga balta e të rivrasin të rënë". Memoria e kombit shqiptar për të rënëve është çimentuar me gjakun e të rënëve nuk matet as me numra e as me kile, "as me okë e as me kokë".

Gjaku është shpagimtar i sollemn i lirisë, themeli i së vërtetës, ideali i trupëzuar në panteonin e jetës prandaj burrat që i dolën zot vatanit meritojnë vetëm nderim. Pesë dëshmorët do jenë roje të lirisë së tokës arbërore, buzë rrugës së re Kardhiq - Delvinë. Ata do të trupëzohen njësh me tokën e gurtë, por dhe të sertë, shpirtërisht të lidhur besa-besë si një gjerdan në kalanë natyrore, por edhe përjetësisht në memorien e brezave. Aktet e mëdha njerëzore i japin kuptim historisë së mbijetesës, për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, për të përjetësuar sakrificat e mëdha për liri dhe mëvetësi, që është historia e vërtetë e këtij kombi, është historia e dëshmorëve. Fakt është se më mirë, më drejtë, më bindshëm flet gjaku i dëshmorëve të Labërisë, flet historia për trimat Sami Golemi e Karafil Bello nga Fushëbardha, Hasan Çerepi nga Zhulati, Sefer Meta nga Golemi, Skënder Pepiaj nga Progonati, që ranë pranë Senicës së Delvinës, do të vijojë të flasë.

shumta shpirtërore. Këtu në Senicë përbri rrugës së re pritët që të marrë jetë një projekt i dy dekadave më parë më 4 prill 2004, kur një grup intelektualësh krijuan Shoqatën "Fushëbardha", por që e firmosur ligjërisht në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14 datë 30.3.2021, "Për miratimin e Propozimit për ngritjen e memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it, pasi gjaku nuk bëhet ujë.

Që prej 80 viteve flakadani i atdhetarisë në truallin e Fushëbardhës, krahinave Kardhiq e Rrëzomë, Delvinës, Labërisë, gjithë Shqipërisë ka qenë i ndezur dhe prushi i patriotizmit gjithmonë i nxehtë. Nuk ka dëshmi më ta madhe e më solide se gjaku për atdhe, për kombin, për lirinë. Ishin pesë dëshmorë që ranë në një copëz toke arbërore në shkurt-marsin e vitit 1944, atje pranë Senicës historike të kuvendeve, nderit dhe lavdisë, të mençurisë dhe punës, të pushkës dhe të diturisë, të punës dhe mund të mbulojë dhe as të fshihet nga kujtesa e kombit shqiptar, ajo lavdi që u shkrua me gjakun e dëshmorëve.

Prandaj liria e ka rrënjët thellë në gjakun e të rënëve. Për këtë arsye poeti qartëson: "...duhet të ngrenë nga balta e të rivrasin të rënë". Memoria e kombit shqiptar për të rënëve është çimentuar me gjakun e të rënëve nuk matet as me numra e as me kile, "as me okë e as me kokë".

### Sami Sejdi Golemi, me pushkë në dorë për lirinë e Atdheut

Sami Sejdi Golemi, ishte lindur më 15.7.1907 në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ai rridhte nga një familje me ndjenja e kontribute patriotike e atdhetare me emër të nderuar në Fushëbardhë dhe në krahinën e Kardhiqit. Fshati i tij i lindjes Fushëbardha është kodrinor e malor, mes malesh, në lagjen e Goleme, ku dimri vjen shpejt dhe ikën vonë, ku pranvera dhe vera ia lënë vendin njëra-tjetres pa shumë ndryshime, veç plot lule e freski në behar dhe shumë dëborë e acar në dimrin e gjatë.

Jeta e detyroi që të përballë herët me vështirësitë në fushë e në mal duke e kapërcyer Qafën e Skërficës ditën e natën në borë e suferinë. Përfundoi shkollën fillore, por vuajtjet dhe hallet e kohës e mësuan të dallonte të mirën nga e keqja, padrejtësinë nga e drejta dhe kjo shpesh e revoltonte djalin e ri fushëbardhiot. Familja e tij ishte një familje e madhe. Babai i tij Sejdiu dhe nëna Nefize kishin tetë djem dhe dy vajza. Fisi i tij, Golemi ishin njerëz punëtorë, të thjeshtë, të dashur e të respektueshëm në fshat e krahinë, kishin shumë miq në krahinat e Kardhiqit dhe Rrëzomës por edhe deri në Përmet, Korçë, Ersekë, Himarë, Delvinë, Zonën e Konispolit e Çamërisë, në Vlorë e Mallakastër. Ishin njerëz zemërbardhë e mikpritës siç i thonë në Labëri, janë familje bukëdhënë, që rrezatonin mirësi. Familja përjetoi siç thotë populli "të zezat e ullirit" veçanërisht në përballjen me andartët grekë më 1913-1914. Viti 1914 shënon edhe dramën e ndarjes forcërisht nga gjiri i familjes së trungut të shtëpisë, babait të tij Sejdiut, i cili u rrëmbye dhe u dërgua në ishullin e Korfuzit me anijen dragaminë me gjithë gjënë e gjallë. E megjithatë familja e tij mbijetoi. Vëllai i madh i Samiut, Kasëm Golemi mbajti vëllezërinë të përbashkuar si dhe në Luftën e Vlorës në 1920 ishte luftëtar me çetën e Fushëbardhës e Zhulatis dhe që kishte luftuar bashkë me Selam Musa Salarinë. Ai ka qenë anëtar i Këshillit Krahinor të krahinës së Kardhiqit deri në çlirimin e vendit. Samiu i doli zot vetes në Fushëbardhë, u burrërua para kohe dhe pas shkollës punuar në bujqësi, por të shquar në blektori, në traditën e Sinanaliajve/Goleme. Në periudhën 15.7.1927 deri 15.7.1929, kreu shërbimin ushtarak në Ushtrinë Kombëtare, në rregjimentin e Gjirokastrës, me disa bashkëmoshatarë të tij. Kjo ishte periudha e "pjekjes



së djelmohave" dhe që ishte detyrë ndaj shtetit bazuar në Ligjin ushtarak "Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare", një ushtri me 700 oficerë, 800 nënoficerë, 7800 ushtarë, që harxhonte deri në gjysmën e buxhetit të shtetit, por që nuk ishte e gatshme ta mbronte realisht vendin. Pas ushtrie Samiu më i rritur dhe i pjekur gjykonte thellë problemet e kohës mbante pranë vetes dhe i mësonte nipçet e tij si Feron, Fejzon etj., me ta kalonte në fushat e në malet e Fushëbardhës, të Çajupit, të Malit të Gjerë, të Delvinës e deri në Bureto. Duke parë shtypjen dhe shfrytëzimin, e urreu regjimin shtypës dhe barbar të Italisë fashiste që erdhi më 7 prill 1939. Më 12 dhjetor 1942 formohet çeta "Çerçiz Topulli" në Fushëbardhë ku, që me themelimin e saj ishte dhe Sami Golemi me bashkëmoshatarë të tij të tjerë. Ai përjetonte një rizgjim të ri të burrërisë shqiptare, kur komandant ishte Dilaver Poçi, komisar Siri Çarçani, zv/komisar Gani Haloçi dhe itendent Mitat Kondi. Çeta "Çerçiz Topulli" e formuar në Fushëbardhë ishte një ndër 288 çeta, që u krijuan gjatë LANÇ-it në të gjithë vendin. Çeta kishte në ditën e parë 27 partizanë që më vonë shkoi 40 partizanë, numër që erdhi gjithmonë në rritje. Sipas planit çeta kaloi fillimisht në Vurg të Delvinës ku u prit me dashuri nga populli. Më pas çeta kaloi në Dermish ku shkatërroi Urën e Çakallos e më pas në Theologo për asgjësimin e postave kufitare të armikut në Zminec, në Vërvë e Leshnicë. Materialet e postave kufitare të armikut u morën nga çeta partizane. Çeta kaloi gjithashtu edhe në fshatin Kulluricë, ku hapi depot e drithit dhe u'a shpërndau fshatarëve të varfër, që bëri bujë të madhe për kohën. Në vitin 1943 çeta luftoi me italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Vasjar të Tepelenës, më 11 dhe 12 qershor 1943, luftoi në Urën e Kardhiqit, në Humelicë dhe Cepo. Në 10 deri më

## ESSE

## VDEKJA DHE KRENARIA JUAJ ËSHTË LIRIA JONË

(DËSHMORI ABEDIN SHAQO LLAPI)

## Neki ÇAKO

“Dëshmorët nuk janë më fizikisht. Por me ne janë idealet dhe vepra e tyre. Nuk janë më nënat e dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por janë mbesat, nipat e stërnipat e tyre. Janë fëmijët e oficerëve dhe policëve të rënë në krye të detyrës. Janë fëmijët, nënat, motrat e vëllezërit e vajzave e djemve të rënë për lirinë e kombeve të tjera, të rënë në luftën kundër terrorizmit e krimin, në luftën për mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës publike” Shpirti vetëmohues është farë që përhapet tek njerëzit, si edukim etnik. Dashuria për vlerat më sublimë, është edukim universal njerëzor. Është nderimi i kujtimit për të. Është vlerësimi ynë i Pikës së Gjakut në kohë e nëpër kohë. Ndaj ne duhet ti pasqyrojmë vlerat dhe bëmat e tyre, e për këtë duhet përkushtim. Po kush ishte Abedin Shaqo Llapi? Ai ka lindur në Nivicë të Tepelenës më, 1912 në një familje të varfër patriotë. Shkolën fillore e mbaroi në fshatin e tij të lindjes në Nivicë. Që prej shumë vjetësh i shtërnguar edhe nga gjëndja ekonomike e vështirë, familjarisht u vendos



në fshatin Bicakaj të qytetit të Lushnjës. Në vitin 1935 ai u aktivizua në lëvizjen e Fierit ku dhe u arrestua për veprimtari të dyshimtë kundra regjimit të zogut.

Për mungesë provash ai u lirua, por u mbajt nën vëzhgim nga forcat e zogut si njeri i dyshimtë. Hapi një dyqan, ku më shumë përdorej si bazë për të shprehur urrejtjen ndaj regjimit, sesa për fitim. Në vitin 1942 ai ra në kontakt me anëtarë të levizjes nacionalçlirimtare duke propoganduar idetë për çlirimin e vëndit nga

zgjedha e rëndë dhe okupatori pushtues. Mori pjesë në njësitet guerile të myzeqesë, ku ka marrë pjesë në shumë aksione. Më vonë do ti ngarkoj detyra e komandantit të kompanisë të kësaj njësie, për t'u zgjedhur më vonë zv/komandant batalioni. Në vëndin Galldere midis Lushnjës dhe Fierit, në një luftë të rreptë në përpjekje me disa ushtarë italianë që nuk pranonin të dorzoheshin, duke bërë rezistencë, Abedini u fut brënda fortifikatave të tyre i çarmatosi dhe i detyroi të dorzoheshin pa gjakderdhje. Në

aksionin e organizuar në vitin 1943 kundër forcave gjermane në bregun e lumit Gjerbës të Skraparit, forcat partizane të tre kompanive ishin në pararojë të batalionit të parë. Kur pararoja u fut plotësisht në lumë forcat gjermane që kishin vënd dominonjës hapën zjarr kundër tyre. Lufta u ndez e ashpër. Lumi ishte i vështirë për t'u kaluar. Shokët duheshin mbrojtur. Abedini beëri thirrje, vazhdoni përpara se do t'ju mbroj unë nga krahët dhe në moment zuri vënd pranë një guri dhe luftoi trimërisht me armë në dorë duke u dhënë mundësi shokëve të batalionit të shpërndaheshin në pozicione luftimi. Lufta vazhdoi për disa orë deri sa forcat gjermane u tërhoqën. Në një përpjekje tjetër të rreptë me forcat pushtuese, në dhjetor të vitit 1943 në Qafë Dardhë, në kufi me Skraparin u plagos rëndë dhe si shkak i plagëve të shumta nuk mundi të jetonte.

Plumbat e mallkuar ja ndërprejnë ëndërrat në mes. Ai e dha jetën për kauzën e popullit dhe të Atdheut. Presidiumi i Kuvëndit Popullor e ka dekoruar me medaljen e Kujtimit, të Trimërisë dhe atë të Çlirimit! Emri, jeta dhe bëmat



e Abedinit do të kujtohen brez pas brezi, sepse, ai e çimentoi me gjakun e tij kauzën e madhe për të qënë të lirë. Emri i tij do të ndrijë përherë si kushtrim në panteonin e lirisë, në pedestalin më të lartë të Atdheut. Lavdi jetës dhe veprave të dëshmorëve! “Mirënjohje e respekt pafund për të gjithë ata djem e vajza, burra e gra që me gjakun e jetën e tyre e vunë Shqipërinë në anën e duhur të historisë “Nuk mjafton të përulemi përpara sakrificës së tyre. Ata dhanë jetën për këtë vënd, për një Shqipëri më të mirë, dhe nuk ka mënyrë më të mirë të denjë për t'i respektuar dëshmorët sesa duke punuar fort, për ta bërë realitet Shqipërinë që ata ëndërruan”.

SAMI GOLEMI BIRI I FUSHËBARDHËS  
GJAKUN E ÇIMENTOI ME LIRINË

## (Vijon nga faqja 11)

12 gusht 1943 çeta ku bënte pjesë Sami Golemi luftoi me milicët italianë. Në 30 dhe 31 gusht 1943 luftoi me garnizonin italian në Libohovë. Në shtator të vitit 1943 batalioni tek ura e Kardhiqit hyn në Gërhot pas kapitullimit të Italisë fashiste. Sami Golemi mori pjesë aktive në të gjitha veprimet luftarake në përbërje të formacioneve të çetave dhe batalionit territoriale dhe të rinisë. Ai u bë luftëtar shumë aktiv duke u gjendur në ballë në shumë aksione luftarake. Shokët e tij partizanë e njihnin Samiun me cilësitë më të mira, si trimërinë, zgjuarsinë, shkathtësinë dhe, për këto, ai gëzonte dashurinë dhe respektin e tyre.

Një pjesë nga katër çetat e batalionit kaloi në batalionin territorial me komandant batalioni trimin Karafil Bello. Sami Golemi në batalionin territorial ishte skuadër komandant dhe me të njëjtën detyrë edhe në batalionin e rinisë. Në luftimet e Senicës së Rrëzomës tek bokërrima e kuqe, pranë qafës së Ujikut, bie heroikisht komandanti i batalionit territorial Karafil Bello në fillim të shkurtit 1944. Batali-

oni u riorganizua përsëri dhe në mes të marsit 1944 kalon në luftime në Senicë, Vergo, Kalasë me gjermanët si dhe bashkëpunorët e tyre. Pararoja bie në përpjekje dhe në këtë luftë vritet Sami Golemi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj dhe Hasan Çerepi. Në të gjitha betejat tregoi guxim dhe trimëri të rrallë, gjaku i tij skuq rrugët e gurta aq të njohura të Senicës, në përlëshje fyt për fyt me fashistët gjermanë dhe tradhëtarët. Ishte agjitor i LANÇ, duke shprehur urrejtjen ndaj okupatorit fashist italian dhe nazist gjerman, ku dhe ra, për të mos vdekur kurrë në luftën për çlirimin e Senicës, një fshat ngjitur me fshatin e tij të lindjes. Samiu ra në fushën e betejës duke lënë jetime vajzën një vjeçare Gurien, pa e njohur vajzën e tij dhe ngeli dëshmor në përjetësinë e nderit të kombit. As vajza nuk e njohu dot babanë e saj, por njohu bashkëluftëtarët shokët e tij të armëve, njohu kujtimin dhe nderimin për përkushtimin heroik të babait dëshmor ndaj lirisë së Atdheut, respektin e brezave për këtë luftëtar të lirisë e kanë shoqëruar bijën e tij gjatë jetës.

Ata i dolën zot Atdheut në kohë

të vështira e rreziku, për lirinë dhe për të pasur shtet, prandaj nderohet e respektohet lufta e tyre, lufta e kombit shqiptar kundër nazizmit, fashizmit e bashkëpunorëve të tyre. Sami Golemi është shpallur “dëshmor i Atdheut” 27 vjet pas rënies me Vendim Nr. 65 datë 2 tetor 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Gjirokastrës. Kujtimi i Sami Golemi dhe dëshmorëve të tjerë, që dhanë jetën do jetë i përjetshëm. Treva labe dhe jo vetëm i ka nderuar dhe nderon në vijimësi brez pas brezi trimat, bijtë që kanë rënë në betejat e historisë për mbrojtjen e truallit arbëror. Ata ranë me armë në dorë për lirinë e Shqipërisë, prandaj dhe meritojnë nderimin në përjetësi.

Memorial i munguar në dekada për djemtë dëshmorë, do shndrohet në frymëzim brezash. Memoriali “Armëbashkuar për flamur” që do ngrihet në përkujtim të 80 vjetorit të rënies të pesë bijëve të Labërisë nga Fushëbardha, Zhulati, Golemi, Progonati do të jetë vlere e çmuar e vëndnderimit të shenjtëruar të lavdisë dhe krenarisë sikurse çdo komb i qytetëruar. Në bibliotekat tona nuk kanë munguar librat, en-

cikolopeditë, monografitë, shkrime të shumta për historitë, artikuj të pafund, në Evropë e më gjerë që përkujtojnë të rënë për Atdhe. Europa është e mbushur me buste, lapidarë e memorialë, pllaka, rrugë, sheshe, shkolla, që mbajnë emrin e tyre.

Nderimi dhe respekti për të rënë në trevën labe me memorialë në kuadrin e tetëdhjetë vjetorit të çlirimit të Atdheut, shpreh vlerësimin e idealeve të çlirimit, madhështinë e fitores dhe lirisë së Atdheut, si dhe devizën e përherëshme kombëtare se, “kur bie për atdhenë mbetet në pavdekësi”.

Prandaj në pavdekësi do të mbeten dëshmorët e LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi (1927-1944) 17 vjeç, Karafil Vehip Bello (1902-1944) 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi (1907-1944) 37 vjeç, Sefer Ramo Meta (1916-1944) 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj (1925-1944) 19 vjeç, ku mosha mesatare ishte 28.6 vjeç. Memoriali i pritshëm për tu ngritur do të mbushë një boshllëk për nderimin dhe mirënjohjen e munguar në tetë dekada për djemtë dëshmorë të cilët ranë me devizën: “Besën për lirinë, gjakun për Atdheun”.

## REPORTAZH

## KUSHTUAR KOSOVËS



Halil RAMA

(Vijon nga faqja 1)

Shtatëmbëdhjetë vite më pas, ndërsa ka sjellë në vëmendjen e opinionit publik këtë të vërtetë të pamohueshme, në takimin e organizuar nga Federata e Paqes Universale Shqipëri, tashmë si President Nderi i kësaj federate, ka falënderuar sërish Presidentin Bush për dakordësinë në atë takim kokë më kokë, me mendimin që ajo situatë statuskuoje e para 17 viteve nuk mund të tolerohej më tutje, duke deklaruar se, “Koha për pavarësinë e Kosovës është tani”. “Kështu – vijoi ish Presidenti Moisiu, në vitin 2008 u krijuan kushtet e plota ndërkombëtare dhe nga Parlamenti i Kosovës u shpall pavarësia e shtetit të ri të shqiptarëve në Kosovë, kur një nga promotorët e kësaj ngjarjeje tepër të rëndësishme do të ishte Presidenti i atëhershëm i Kosovës, shkëlqesia e tij Fatmir Sejdiu.

I ftuar nderi në veprimtarinë e së shtunës të Këshillit të Paqes Tiranë, Presidenti Sejdiu, ndërsa evidentoi përpjekjet shekullore të shqiptarëve për ta detyruar Serbinë të dështojë në qëllimin e saj kryesor për zhbërjen e shtetit shqiptar, e konsideroi të suksesshëm rrugëtimin e Kosovës drejt farkëtimit të paqes. E pas tij, edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë, Skënder Durmishi deklaroi se Kosova e do paqen, Kosova punon për paqen...

Në të njëjtën linjë, edhe prof. dr. akademik Pëllumb Xhufi sollti në vëmendjen e më shumë se 200 pjesëmarrësve elitare në këtë takim, ambasadorë të paqes nga Shqipëria e Kosova, deklarantë e bërë para 110 vitesh në Bari të Italisë nga i pari kryetar i shtetit shqiptar, Ismail Qemali, se pa i dhënë Shqipërisë Kosovë e Çamëri, Ballkani nuk do të ketë paqe. Dhe ndërsa argumentoi se si edhe pas 110 vjetësh kur Kosova shtet demokratik i pavarur, realitet i pakthyeshem, është politika serbe, faktori që rrezikon paqen në Ballkan, akademiku i mirënjohur Xhufi evidentoi dukshëm rolin e dy presidentëve Moisiu e Sejdiu si ndërtues urash të komunikimit për paqen midis popujve.

Në këtë event kushtuar Kosovës në 16-vjetorin e pavarësisë së saj, të ideuar dhe moderuar mjeshtërisht nga ikona e skenës dhe ekranit Defrim Methasani, artisti shqiptar me famë botërore Ilir Shaqiri, i ftuar jo vetëm për t'u lauruar me titullin “Ambasador i paqes”, por edhe për performuar para këtij publiku ndër më të zgjedhurit, e flakëroi sallën moderne të FPU, ku



zëri i tij vetëtimë ushtoi me vargjet: “..."

Në Prekaz flakëron liria” e “Shqipëri o Nënë e Madhe/ Më e shtrenjta dashuri/ Kuqezi djemtë e atdheut/ përjetësisht me ty Shqipëri”.

Kjo këngë, këto vargje të interpretuara aq mjeshtërisht nga një zë kumbues si i Ilir Shaqirit ndez në zemrat e çdo shqiptari ndjenjën e madhe të shqiptarizmes.

Kështu ndodhi edhe me Liri Rashën, e dekoruar jo vetëm me titullin “Mjeshtër i Madh”, por edhe “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”, tekta interpreton këngën e bashkimit, vargjet së cilës: “Ndal shkja me m’shkel në prag/ Ti je serb e unë jam arb”, janë sintezë e qëndresës shumëshekullore të shqiptarëve në luftërat legjendare ndaj pushtuesve serbë.

Parë nga ky këndvështrim, veprimtaria e titulluar “Kosova e pavarur-model suksesi për paqen”, organizuar nga Këshilli Paqes Tiranë në bashkëpunim me FPU Shqipëri që e një dimension i mbarëkombëtar.

Sepse nga podiumi i këtij takimi, ndërsa kujtoi se në vitin 1936 dhe 1937 në shkollat fillore këndonin këngën “Për Kosovë e Çamëri, ja vdekje ja liri”, ish-Presidenti Moisiu do të deklaronte se, “Pavarësisht se Shqipëria është anëtare e NATO-s, në rast se Kosova rrezikohet, të gjithë së bashku duhet t'i dalim zot”.

Si ideator dhe moderator i këtij takimi emocionues dhe vlerësues, Defrim Methasani nuk hezitoi të shprehej se ndjehej i lumtur për pjesëmarrjen e shumë personaliteteve nga Kosova dhe Shqipëria, ku nuk munguan edhe Presidentët Alfred Moisiu dhe Fatmir Sejdiu, si dhe ambasadori i Kosovës në Tiranë, z. Skënder Durmishi.

Veprimtaria kulmoi me vlerësimet që nderuan njerëz dhe vlera në dy vendet, duke nisur me çmimin “Njeriu i Vitit”, që Këshilli Paqes Tiranë e aplikoi për herë të parë dhe ia dedikoi mje-

kut stomatolog dhe njeriut humanist Sali Kurti, “Mjeshtër i Madh” dhe “Qytetar Nderi” i Matit.

Më pas u emëruan me titullin “Ambasador për Paqen” 11 protagonistë të fushave të ndryshme, si Ismet Krasniqi, kryetar i KOK Kosovë, Ilir Shaqiri, artist i madh dhe “Nderi i Republikës së Kosovës”, Bieta Sulo, gazetare dhe moderatore e njohur në “Top Chanel”, me emisionin “Ftesë në 5”, dr. Hekuran Braho, otorinolog prej 40 vitesh në Spitalin Ushtarak, Enver Cakiqi, kampion ndërkombëtar në karate dhe President Nderi i kësaj federate në Shqipëri, Edmond Thaçi, President i Shoqatës së gazetarëve sportiv në Kosovë, Suzana Drenica, koreografe në Prishtinë, Albana Shehu Qiriako, gazetare dhe drejtore e RTSH 3, kanali i diasporës, Nadire Karadaku, juriste e njohur, notere dhe veprimtare, Shkëlzen Rexha, fotoreporter dhe fitues i shumë çmimeve nga Gjakova, si dhe dr. Endri Abazi, kardio-kirurg në spitalin e njohur në Buh në Berlin.

Moderatori Methasani, ndërsa shprehu mirënjohje për referencat dhe fjalët përshëndetëse nga Presidentët Moisiu e Sejdiu, ambasadori Durmishi dhe historiani prof. Xhufi, falënderoj edhe artistët e shquar Ilir Shaqiri dhe Liri Rasha që performuan kaq bukur me këngët e tyre. Po ashtu, ndërsa ka shprehur mirënjohjen për secilin që ishte i pranishëm, veçmas për kryetaret e federatave të paqes në Shqipëri dhe Kosovë, Eva Çipi dhe Flora Brovina, zv.kryetarin e FPU Astrit Q. Memia, zotin Gaqo Apostoli koordinator për diasporën i FPU, kryesinë e federatës së paqes Kosovë etj., moderatori Methasani – “Mjeshtër i Madh”, njëherësh kryetar i Këshillit të Paqes për Tiranën, një dedikim të veçantë i kushtoi stafit të Ambasadës së Paqes dhe Federatës së paqes, veçmas sekretari të përgjithshëm, Gani Rroshi, me të cilin, kur janë bashkë, bëjnë gjëra të mira, siç që dhe kjo veprimtari e dimensionit dhe përmasave mbarëkombëtare.

## KULTURË


## PUKA, KRAHINË ETNOGRAFIKE

Xhemal MEÇI

Studjues &amp; Mjeshtër i Madh

Rrethi i Pukës me ndarjen administrative të vitit 1945, u tkurr brenda kufijve krahinorë, duke humbur nga lindja Spasin (Malziun, Shumërine) që iu dha Kukësit. Ndërsa nga perëndimi i kaluan Shkodrës: Dushi e Karma e Poshtme, Mdhoja dhe tash se fundi Komani. Në të njëjtën kohë iu bashkangjiten Pukës, një numër i madh fshatrash mirditore që nga Lumardhi deri në Rras- Kuzhnen bashkë me Srriqen, si edhe Korthpulën, Vrrithin, Kaftallen etj.

Tani le t'i kthehemi problemit të shtruar për zgjidhje: A është Puka krahinë etnografike? Përgjithësisht ne rrethet shkencore qendrore mbizoteron mendimi i gabuar se Puka nuk është krahinë unike etnografike, por një përbërje krahinash a copërash të shkëputura prej krahinës së madhe të Dukagjinit mesjetar. Ja si e shpreh këtë «Etnografia shqiptare» (I/1962., f. 37-38): «Berisha, Mërturi, Hasi, Luma etj. vazhduan te zhvillonin me tutje veçoritë kulturore te veçanta që krijuan (pas pushtimit osman- Xh M.). As Fjalori Enciklopedik Shqiptar (botim i vitit 1985) nuk mund t'i shpëtojë, kësaj pasaktësie, sepse në f. 543 shënon: «Krahina e Dukagjinit» u nda në disa krahina të reja, si: Mirdita, Luma, Hasi, Berisha etj.». Nga sa thuhet më sipër del pyetja: << Si lindi dhe u kristalizua mendimi i gabuar se Puka nuk është krahinë etnografike unike?». Sigurisht, ky mendim nuk lindi rastësisht dhe pa një bazë të



**Fillimisht është me interes që të sqarojmë lexuesit se ç'është Krahina etnografike dhe sa përputhet rrethi i sotëm i Pukës me traditën e vet etnografike. Krahina etnografike është njesia e caktuar ekonomiko - shoqërore njerëzish, me kushte shoqërore të njëjta, me mënyrë të përbashkët jetese dhe me lidhje të ngushta kulturore, të formuara në rrethana të caktuara historike, krahas tipareve të përgjithshme etnike -Kombëtare.**

caktuar të dhënash dhe ngjashmërisht. Le t'i analizojmë disa prej tyre. Në Udhën e Madhe verilindore, që lidhte Adriatikun me pjeset e brendshme të Ballkanit, dihet se që nga kohët antike e në vazhdim Puka, Iballa e Spasi (Vaspasi, Malziuni) kanë qënë vazhdimisht stacione të fortifikuara me rëndësi në mbrojtje të kësaj udhe. Njëkohësisht, shërbenin edhe si qendra të rëndësishme banimi me funksione administrative, politike dhe ekonomike për rrethinat e tyre perkatëse, por të pashkëputura ne kuader krahinor: Megjithatë, duke qënë të ndara

nga largësi të mëdha dhe me kufij të dukshëm gjeografikë, mjaft studiues te huaj e vendas i moren për qendra krahinash të vogla e të veçuara në tipare etnografike. Kjo edhe për faktin se studiues si Hani, Durham etj., duke i parë kalimthi disa fshatra e vise, i kanë trajtuar si fise e rrethina të mbyllura brenda vetvetës. Edhe sot disa studiues vendas, të mbështetur mbi traditën e shkruar edhe mbi veshime anësore vazhdojnë ta trajtojnë Pukën si një krahinë gjeografike tranzitore, ndërlidhëse dhe pothuajse pa identitet etnografik, Atëhere me ç'argumenta

mund të dëshmojmë të kundërtën?

**Se pari:** le t'i drejtohem Frang Bardhit, historianit, folkloristit dhe etnografit tone të shek. XVII, i cili, mbasi ka vizituar disa herë viset e Pukës, shkruante me 1638: «Per veset e virtytet, zakonet e mira e të këqija, për bestytnitë, për mënyren se si me kremtue festat me sofrë, për gjendjen, pasuninë dhe veprimet e këtyne popujve iballas, gjanësisht kam tregue në relacionet e vizitës në Pukë 1637, dhe aty mund te shihen sepse iballasit janë fqinj dhe në marrëdhënie me ata të Pukës e të Spasit dhe hyjnë në të njëjtin përshkrim». Siç shihet, uniteti kahinor etnografik del i qartë.

**Së dyti,** në mëndësinë e popullit është ruajtur si një fakt real uniteti krahinor etnografik, siç dëshmojnë emërtimet tradicionale: Dheu i Epër e Tre Bajrakt e Epër (për Iballen); Dheu i Poshtëm e Tre Bajrakt e Poshtëm (për Pukën). Spasi është njohur si Dheu i Malitzi a Bajraku i Malitzi. Vetë ndarja: Dheu i Epër e Dheu i Poshtëm flet për pjesë të së njëjtës njësi. Po kështu Shtatë Bajrakt e Pukës (Tre Bajrakt e Epër, Tre Bajrakt e Poshtëm e Bajraku i Malitzi) shprehin shtatë ndarjet e mëvonshme administrative në njësi më të vogla, por pa shprishur krahinëen.

**Së treti,** uniteti krahinor etnografik i Pukës është i dukshëm edhe sot. në veshjet tradicionale, ndërtimet banesore, në krijimet artistike letrare gojore e muzikore, në vallet, në doket, e zakonet, në të folmen e përbashkët të Pukës etj.

**Së katërti,** uniteti krahinor shprehet mjaft qart me traditat krahinore të së drejtës juridike popullore e njohur me emrin Kanuni i Lekë Dukagjinit (Xh.M -Kanuni i Lekë Duhagjinit, varianti i Pukës, botimi II, Shkodër 2019), ku përfshihej Pukë-Kabash, Iballë-Bugjon, Berishë e Malziu.

**Si përfundim,** pra Puka është një krahinë etnografike e përbërë prej tri njësisish visnore: Pukë, Iballa e Spas me lidhje të ngushta tradicionale.

## RAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË

(Vijon nga faqja 5)

shkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shëmbëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën gjeneral Rrahman Parllaku, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare. Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përbaljes në gjyqë ushtarake, përballoi burgje e privime



dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime.

Ai është një model i ardhur nga gjenocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja. Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë edhe në moshë pensioni një ndihmesë të vyer në emancipimin politik-shoqëror e demokratik të shoqërisë.

Si një lundëtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

\* Mjeshtër i Madh

## SUPLEMENTI LETRAT

# Mesazhi i bashkshortes së shkrimtarit Shefki Karadaku

Në këto kohë të krizës globale, të promovosh paqen është shërbimi më i mirë që i bëhet njerëzimit. Pikërisht këtë mesazh përcolli Nadire Karadaku, e njohur si gazetarja, redaktorja, juristja, noterja, nëna dhe bashkëshortja shembullore model i gruas fisnike e me inteligjencë të rrallë, ditën që Federata e Paqes Universale Shqipëri i dha titullin “Ambasadore e Paqes”. Kjo edhe për faktin se ndoshta si askush tjetër ajo ka kontribut të veçantë si bashkëpunëtorja më e denjë, redaktorja dhe botuesja e dhjetëra librave të bashkëshortit të saj, shkrimtarit të mirënjohur Shefki Karadaku.

Dhe teksa i përmend bashkëshortin, ajo përloitet, pasi për të, Shefkiu ishte në sintoni të plotë si shkrimtar dhe njeri i mrekullueshëm. Ndjaj dhe pohon njëzëshëm se ka qenë me fat që për rreth gjysmë shekulli ishte përkrah tij. Ai nuk jeton më, por kudo që rrotullohet në shtëpi, i duket sikur e ka pranë, pasi kudo prek librat e shumë të tij që përbëjnë një pasuri tejet të vyer, jo vetëm për familjen, por para së gjithash për kulturën tonë kombëtare. Krahas punës së përditshme në zyrën noteriale të së bijës Albanës, për punën dhe shembullin e së cilës ndjehet krenare, ajo flet me krenari për veprën letrare të bashkëshortit.

“Mjafton të kujtosh analizën e shqiptaro-maqedonasit Lutfi Turkeshi në gazetën ‘Fjala’ të shqiptarëve të Shkupit, (i panjohur për Shefkiun) i cili e quan “Kajani i ditëve tona” dhe “një autor i madh”... Moikom Zeqon që e krahason me Jetsin, Enver Kushin që e quan “poeti i reve”; Xhevat Mustafën që shkruan në ditën që ai ndërroi jetë tre vjet më parë, më 16 mars 2021, se ‘u shua një yll i letërsisë shqipe’. Erika Beermann, albanologe dhe studiuese e vendeve të Europës Juglindore e quan një nga autorët e famshëm të vendeve të Europës Juglindore dhe e boton me shkrimtarët më të mëdhenj të kohës, në një antologji me karakter studimor në vitin 1995 në Gjermani...

Shefi i katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Sorbonës, Kristian Guut, i shkruan se e vlerëson shumë lart krijimtarinë e tij”, – thotë Nadirja. Dhe është vërtetë rast i rrallë, që me kontributin e saj financiar (ndonëse në pension), në përgjigje të kërkesës së lexuesve, ajo ribotoi në shqip dhe anglisht romanin “Puthja e ngrirë” të bashkëshortit të saj Sh.Karadaku – autor i 35 veprave letrare në prozë e poezi (mes të cilëve romanet kryevepra: “Sagë Mbretërore”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Apokalipsi i gjetheve”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi” etj.), tre vjet pas ndarjes së tij nga jeta.

## FRYMËZUESE E KRIJIMTARISË SË BASHKËSHORTIT

Nadire Karadaku është ndoshta nga zonjat e rralla jo vetëm si frymëzuese e krijimtarisë së bashkëshortit të saj të ndjerë, shkrimtarit të mirënjohur e shumë të suksesshëm, Shefki Karadaku, por edhe mbështetësja e financuesja e botimit të 20 librave të tij. E sapodiplomuar për gjuhë-letërsi (dhe më pas edhe juriste e funksionare në Ministrinë e Drejtësisë), që në rininë e saj ka shkruar dhe botuar poezi, skica e tregime të arrira artistikisht dhe të vlerësuar nga lexuesi i asaj kohe. Ditën e që mori titullin “Ambasadore e Paqes” nga FPU, u prezantua jo vetëm si njohëse perfekte e letërsisë botërore e asaj shqiptare, por edhe si një kritike e mirëfilltë letrare.

Atë mund ta veçojmë si një ndër të paktat gra shkrimtarësh që u janë përkushtuar bashkëshortëve të tyre, duke i krijuar Sh.Karadakut një mjedis të qetë familjar, mbështetur dhe inkurajuar atë për shkruar dhe botuar librat, por edhe duke e këshilluar edhe me mendime kritike. Sepse e adhuron letërsinë. Që në adoleshencën e hershme ka lexuar klasikët e botës, të përkthyer mjeshhtërisht tek ne, si Tolstoin, Shekspirin, Dostojevskin, Pushkinin, Gogolin, Çehovin, Heminguejn, Re Markun, Drajzërin, Hygojn,



Balzakun, Mopasanin, Gollsuorthin, Arçibald Kronin e shumë e shumë të tjerë. Në këtë këndvështrim, ajo pohon se ishte me fat që bashkëshorti i saj, ishte poet dhe prozator me shumë talent.

## RRËFIMI PËR “PAKTIN” ME BASHKËSHORTIN SHKRIMTAR

Krahas kujtimeve të bukura, Nadirja kujton edhe realitete të trishta që përjetoj me bashkëshortin e saj. “Gjatë periudhës së diktaturës, Shefkiu botoi 9 libra, sigurisht duke u munduar të ishin brenda kornizave të kohës. Krahas këtyre botimeve, duke filluar nga viti 1972 deri në vitin 1985 shkroi gradualisht vëllimin me poezi ‘FENIKS’ dhe në vitin 1976-77 novelat ‘Arkadia e largët’. Mbjaj mend se rreth viteve 1976-1977 kishte shkruar dhe përgatitur për shtyp një roman. E çoi në shtëpinë botuese ‘Naim Frashëri’ dhe nga recensionistët u dhanë vlerësime pozitive, ndaj dhe libri hyri në shtyp për botim. Por kur prisim të dilte romani, u njoftua se ky roman ishte kthyer në karton. Shefkiu ishte tepër i ndjeshëm dhe erdhi në shtëpi i dërmuar moralisht.

Pasi mësova se pse ishte dëshpëruar aq shumë, i thashë: ‘Ti e kupton se në ç’kohë jetojmë?! A bëjmë një pakt bashkë?! Ti vazhdo të shkruash dhe shkrimet e tua do t’i lexoj vetëm unë, nuk do t’i çosh për botim’... Dhe natyrisht, poezitë e ‘FENIKS’-it apo novelat e ‘Arkadia e Largët’ nuk mund t’i dërgonte për botim, pasi kur doli në dritë botimi i tyre (viti 1993) ne do ishim harruar”, – rrëfen mjeshhtërisht Nadirja. Më tej, ajo pohon se si i ka ruajtur me fanatizëm dorëshkrimet e ‘FENIKS’-it dhe ‘Arkadisë së largët’, si dhe romanin “Puthja e ngrirë”. Poezitë e ‘FENIKS’-it, Shefki Karadaku i daktilografoi vetë në redaksinë e revistës “Ylli”, ku punoi për 20 vjet rresht.

I përfundoi së daktilografuari rreth viteve 1986-1987. Nadirja pohon se i ka lexuar mbasi i daktilografoi dhe ika thënë së nëse do vijë një ditë që të botohet, të mos ia japë askujt për redaktim, pasi këto poezi nuk kanë nevojë për t’u hequr dhe as për t’u shtuar asnjë pikë dhe asnjë presje. Dhe në të vërtetë nuk ishte gabuar. “FENIKS”-i u prit mjaft mirë dhe u vlerësua me nota maksimale nga kritikë, specialistë të fushës dhe dashamirës të letërsisë. Madje, Erika Beermann, albanologe dhe studiuese e vendeve të Europës Juglindore e quan Shefkli Karadakun një nga autorët e famshëm të vendeve juglindore dhe e boton me shkrimtarët më të mëdhenj të kohës, në një antologji me karakter studimor në vitin 1995 në Gjermani.

Po ashtu, shefi i katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Sorbonës, Kristian Guut, i shkruan se e vlerëson shumë lart krijimtarinë e tij. Ndjeshmërinë e Shefkiut, bashkëshortja e tij e ilustron edhe me një shembull tjetër.

“Ne kemi një shtëpi në një fshat të Tiranës.

- Nadire Karadaku është ndoshta nga zonjat e rralla jo vetëm si frymëzuese e krijimtarisë së bashkëshortit të saj të ndjerë, shkrimtarit të mirënjohur e shumë të suksesshëm, Shefki Karadaku, por edhe mbështetësja e financuesja e botimit të 20 librave të tij



Shkonim në çdo fundjavë. E adhuronte atë shtëpi, pasi natyra atje është e virgjër. Kur niseshim për në fshat, nuk harronte të merrte me vete ushqim për zogjtë apo për ndonjë kafshë shtëpiake që mund të kishte mbetur pa ngrënë (ne nuk mbajmë kafshë në shtëpi). Kënaqej kur ndihmonte financiarisht banorët e fshatit. Ishte njeri me zemër të madhe. Ndjente kënaqësi të paparë kur redaktonte librat që i jepnin shokët apo miqtë... dhe gjithçka e bënte falas dhe me shumë kënaqësi”, – shprehet Nadirja.

Duke pohuar shpirtin e artistit dhe jo të tregtarit që kishte bashkëshorti, Nadirja thotë se të gjithë librat e Shefkiut, (26 botime pas viteve ‘90) janë botuar nga vetë familja pa asnjë subvencion. Si adhuruese e letërsisë edhe krijimtarinë e Shefkiut, ajo çmon si brilante, prandaj thotë se ka pasur kënaqësi të shpenzoj për botimin e librave të tij, i cili i la kulturës shqiptare 35 botime me vlera të mëdha artistike, por edhe për mesazhet që ato përcjellin.

## QË TË MOS KETË MË “PUTHJE TË NGRIRË”

Mes 35 veprave letrare (13 vëllime me poezi dhe 12 romane e 10 libra me tregime e novela) që përbëjnë trashëgiminë letrare që na la Shefki Karadaku, vlerësuar kjo nga të mëdhenjtë e letrave shqipe: Dritëro Agolli, Lllazar Siliqi, Petro Marko etj., romani “Puthja e ngrirë” vlerësohet si më i miri nga lexuesi. Treguesi më i qartë është ribotimi këto ditë për herë të tretë i këtij romani, (në shqip dhe anglisht) nga bashkëshortja e tij Nadirja, me kërkesën e lexuesve.

Kjo për faktin se që në paradigme të titullit të romanit “Puthja e ngrirë” futemi përkitazi, në një botë simbolike, përmes reales dhe ireales, jetës dhe vdekjes, dashurish mes puthjesh dhe lektisjesh plot pasion në ngjizje të ardhmërisë dhe ngrirjes. Përshkruhen mjeshhtërisht artistikisht nga një penë e artë, si Sh. Karadaku: e ngrira, e acarta, e ftohta prej akulli, në imagjinatën e një bote që mbetet pas në kohë dhe hapësirë dhe që është e destinuar të humbasë dhe shkrihet si akulli, sintetizuar kjo të personazhi kryesor, Rroku që ngrihet mbi sistemin që ka mbajtur në këmbë të atin dhe familjen e saj.

Kësisoj ‘Puthja e ngrirë’ ka një natyrë moderne për sa i përket portretizimit të personazheve, si natyra njerëzore, që në dukje kanë tipare të veçanta, fytyrë, veshje, shtat etj., që ngjajnë dhe janë krejt të kundërt me njëri-tjetrin sa u përket karaktereve, çuditërisht, që nga Pigali, Meku, Zurba Sina dhe deri te Basriu, Rroku, Zibeli, Kanadi të ndarë në dy kat-

(Vijon në faqen 15)

## SUPELEMENTI LETRAT

## TRIMËRI, GUXIM, MENÇURI..

## CIKËL ME POEZI NGA ÇOBO SKËNDERI

## KËNGË PËR LABËRINË

(Dhuratë Grupit legjendar të këngës labe, ujeve të Bençës)

Laberi kurorë lavdie,  
Djep e vatër trimërie,  
Dashurinë për atdhe,  
Thellë në shpirt e zemër ke,  
Në çdo kohë e në çdo mot,  
I ke dalur për ditë Zot,  
Si me bij dhe me bija,  
Që s'i mposht dot as stuhia,  
Që me pushkë dhe me shpatë,  
Kan luftuar ditë e natë,  
Që ky komb legjendar,  
Dritë e diell të ketë parë,  
Dhe përjetë te ky planet,  
Të ketë paqe dhe shëndet.

28 - NENTOR - 1982

Dhe për paqe e miqësi.  
Se ky djep është mjaft i vjetër,  
I pa shok në vend tjetër;  
Po të dha ky fjal a besë,  
Nuk e shkel jo, sa të vdesë.

RESPEKT PER KETE PILOT MENDJE  
E DUARTE

Mundin, djersën dhe gjakun  
Që ka derdhur Aviacioni Shqiptar.  
Njazi Nela e ka hedhur në një ditar,  
Ku pasqyron bijtë e shqipes shpirtçelik,  
Që nuk kishin frikë nga as dhe një armik.

TIRANE - 2022

## KËNGË PËR TRI KALATË

Sot nga avioni sodis me dashuri,  
Te tri kalatë e strategut Ali.  
Ato patjetër zemrat e tija qenë,  
Që për disa dekada tundën dhenë.  
Ndër to më e bukur dhe me lavdi,  
Ishte kjo e Janinës mes liqenit gri.  
Këtu shpesh herë priti e përcolli,  
Ai kë duaj, kë s'duaj Stambolli.  
Mes tyre kishte fatosa shqiptarë,  
Poetë të rrallë e diplomat ziliqarë.  
Ai s'qe sulltan, as princ, as perandor,  
Po bir i Skënderbeut kryearbëror.  
Në territorin që posedonte vetë,  
Ligjvënës ishte sa një kryembret.  
Sot nga avioni sodis me dashuri,  
Kalanë, ku trupi i ndarë nga koka rri!!!

## DY YJEVE TË KËNGSS LABE

Parau dhe Goliku,  
Dy yje të ndritur,  
Që natyra i shpiku,  
Kombit lavdinë për t'ia rritur..



## NËNA ËSHTË E SHENJTË SI PERËNDITË

Fort më thotë shpirti një ditë:  
Nëna është e shenjtë si perënditë,  
Ajo të jep: jetë, mend, shëndet,  
Ajo të jep fuqi, të mposhtësh rrufetë.  
Kur iku ajo, rashë përtokë,  
Po ajo do t'i ketë thënë deles,  
Që më zgjoi duke më puthur:  
Në buzë, fytyrë dhe kokë.

PROGONAT - 1953

## ËSHTË E VËRTETË

Fluturoj mbi Progonat,  
Po, po shpesh, ditë e natë,  
Se ai është djepi im,  
Që mi dha jetës guxim.  
Ai më drejtoi drejt qiellit,  
Afër hënës e diellit,  
Të mbroj hapsirën qiellore,  
Të mbarë tokës arbërore.

RINAS - 1963

## TRIMËRI, GUXIM, MENÇURI

-Mbas një fluturimi natën në kondita shumë të  
vështira meteorologjike në Shangaj-

Më thotë kolegu L I :  
Pilot do të thotë:  
Trimëri, guxim, mençuri,  
Që frikën apo rrezikun  
I ka hedhur në hi....

UHAN - 1973

## JEMI

Bij shqiponjash neve jemi,  
Ndaj kërkënd frikë s'kemi,  
Dhe luftojmë natë e ditë,  
Që ky djep të ketë dritë.  
Që çdo bijë e çdo bir,  
Të jetojë sa më mirë,  
Të jetojë e të luftojë,  
Që mbarë kombin ta bashkojë,  
Që ëndërr e Gjergjit te ky djep,  
Të lulëzojë cep më cep.

28 NENTOR - 1982



## KËNGË PËR LUMIN E FSHATIT TIM

Gurra jonë në Progonat,  
Ia thotë këngës ditë e natë,  
Për të shenjtin mëmëdhe,  
Dhe të shtrenjtin Skënderbe,  
Për shqiponja dhe bilbila,  
Për thëllëza e trëndafila,  
Si për burrin dhe për gruan,  
Që për vendin u flijuan.  
Se ky truall arbëror,  
Në çdo kohë mban kurorë,  
Për guxim e trimëri,

Mesazhi i bashkshortes  
së shkrimtarit  
Shefki Karadaku

(Vijon nga faqja 14)

egori: tri të parët, edhe pse përmenden rëndom në roman, nuk kanë identikit, janë pa fytyrë, pa shëmbëllim, vetëm emra simbol, e megjithëkëtë, janë kaq të qartë dhe prezentë në sytë e lexuesit. Të tjerët, madje edhe dy shoqëruesit-vëzhgues, njëri me fytyrë të kuqe si spec dhe tjetri plot prenjka, janë të karakterizuar nga idetë që mbar-tin, mënyra e të jetuarit plot vitalitet, përmes sakrificës dhe jo rutinës. Por ajo që është padyshim linja më e bukur e romanit, është dashuria e Rrokut me Zibelin.

A thua se nuk i pengon aspak përkatësia shoqërore, rendi klasor dhe ekonomik? Në realitetin e kohës kur dy botë përplasen me antagonizma për jetë a vdekje, nuk ndodhte, porse në letërsi frikshëm, e justifikuar dhe e përligjur kjo dashuri. Sikundër dhe antitezat e Kadillakëve dhe vilave plot shkëlqim të familjes Sina, me kasollet e braktisura, bodrumin e Basriut dhe Rrokut, me krevate hekuri dhe kamionët që hiqen zvarre nëpër baltë, në roman janë të justifikuar. Kësisoj, falë kontributit modest të bashkeshortës, "Puthja e ngrirë" e Shefki Karadaku, botuar në fillim të viteve '90, vjen sërish me këtë ribotim me tjetër frymë, me qetësinë e asaj çka mbetur në të shkuarën; me gëzimin e së sotmes që e përmend atë si një ëndërr të keqe si lajtmotiv për një jetë më të mirë të shqiptarëve, pas një burgu të hapur në sytë e botës.

Dhe e shkuara është dhe përbën histori... Ndoshta si askush, Nadire Karadaku është angazhuar në përjetësimin e veprës së bashkeshortit shkrimtar edhe tre vjet pas ndarjes së tij nga jeta, (më 16 mars 2021 në moshën 80 vjeç), qoftë si bashkërealizuese e dokumentarit "AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadaku" dhe në organizimin e përkujtimit të ditëlindjeve të tij me praninë e divës së skenës dhe ekranit Margarita Xhepa - "Nderi i Kombit", që i ka përzemër dhe i interpreton mjeshtërisht poezitë e këtij kolosi të letrave shqipe, si dhe dhjetëra miqve e bash-

## PERSONAZH

Vlerësimi nga FPU për mbi 30 akte humanizmi për shtresat në nevojë dhe për trajtimin me çmime të reduktuara të studentëve ekselentë

# Prof. dr. Sali Kurti, “PERSONALITETI I VITIT” 2023

Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Është bërë traditë, që çdo fund a fillim viti, media dhe institucione të njohura, të shpallin “NJERIUN E VITIT”. Por kur këtë titull ta jep një organizatë prestigjioze ndërkombëtare, siç ja dha Federata e Paqes Universale Prof. dr. Sali Kurtit, ky titull i tejkalon përmasat dhe dimensionet për të cilat është themeluar. Kjo, ndoshta edhe për faktin se në më pak se një vit nga nënshkrimi i Marrëveshjes me Agjencinë e Rinisë të Bashkisë Tiranë, Prof.dr. Sali Kurti ka trajtuar me çmime të reduktuara në Klinikën “Mat Dental” dhjetra studentë ekselentë dhe dhjetra veteranë të LANÇ e të moshuar të tjerë, me e pa pension. Dhe jo vetëm kaq. Në një vit ai ka ndihmuar materialisht mbi 30 familje në nevojë të rrethit të Matit me orendi e pajisje shtëpiake dhe pako ushqimore. Pikërisht për këto akte humanizmi të pashoq, Federata e Paqes Universale Shqipëri, e përzgjedhi atë ndër gjashtë mijë e pesëqind ambasadorët për paqe të Shqipërisë dhe Kosovës, për ta vlerësuar me titullin “Personaliteti i vitit”, titull ku që aplikohet për herë të parë nga ky institucion prestigjioz ndërkombëtar.

Ndërsa i ka dhënë trofenë e këtij titulli, në një nga eventet më të rëndësishëm të FPU, me rastin e 16 - vjetorit të pavarësisë së Kosovës, në praninë e dyqind personaliteteve akademike, shkencore dhe publicistike, mes të cilëve edhe ish-presidentët Moisiu e Sej-



**Ish-Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin “Mjeshtër i Madh”, ndër të tjera është shprehur se: “Doktor Sali Kurti ia ka kushtuar jetën profesionit të mjekut, një profesion ky i nderuar, por edhe i vështirë. Me një karrierë të gjatë, gati prej 5 dekadash, ai është kthyer në shembullin e njeriut të punës, duke u dalluar për përkushtimin, mirësinë dhe humanizmin e tij”.**

diu, Kreu i Këshillit të Paqes Tiranë, Defrim Methasani tha se është në nderin e kësaj Fedetare që këtë titull, tashmë institucional e aplikojnë duke ja dhënë për herë të parë Prof. Dr. Sali Kurtit, Mjeshtër i Madh dhe Qytetar Nderi i Matit.

Sepse është vërtetë shembull i rrallë prania e tij në çdo familje në nevojë deri në fshatrat e thellë malorë të Matit, si dhe trajtimi me çmime të reduktuara i studentëve e nxënësve ekselentë në klinikën e tij dentare, në zemër të kryeqytetit. Dhe, ko jo me fjalë, por me statistika e evidenca të sakta në arkivën e këtij institucioni legal. Qoftë dhe nga një vështrim i përciptë i regjistrit të të trajtuarve gjithkush do të kontaktonte emra studentësh ekselentë nga të gjitha rrethet e vendit, të trajtuar me çmime të reduktuara nga dr. Sali Kurti, e shprehur kjo dhe në opinionet e tyre në librin e përshtypjeve të kësaj klinike.

Ky shërbim i ofruar sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Rinisë të Bashkisë Tiranë Nr.347 Prot, date 15.05.2023 është zbatimi më i përpiktë i detyrimeve të Kartës së Studentit nga Prof.Dr.Sali Kurti, me drejtësi, ndershmëri, mirëbesim, korrektësi, vullnet, transparencë dhe barazi. Këto virtyte të larta njerëzore e karakterizojnë atë edhe në trajtimin e pensionistëve e veteranëve pa përkrahje. të cilët vlerësojnë personalitetin e Prof. Dr. SALI KURTIT si mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore, intelektuale dhe profesionale...

Ndaj nuk është rastësi që klinika dentare “MAT DENTAL”, e themeluar dhe drejtuar prej tij të jetë për çdo ditë e tejmbushur me pacientë që presin në radhë për të marrë shërbimin e kërkuar, tregues ky mjaft sinjifikativ i besimit të tyre për një shërbim të standar-



deve bashkohore në këtë klinikë ndër më konkurrueset në metropolin shqiptar...

Ish-Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin “Mjeshtër i Madh”, ndër të tjera është shprehur se: “Doktor Sali Kurti ia ka kushtuar jetën profesionit të mjekut, një profesion ky i nderuar, por edhe i vështirë. Me një karrierë të gjatë, gati prej 5 dekadash, ai është kthyer në shembullin e njeriut të punës, duke u dalluar për përkushtimin, mirësinë dhe humanizmin e tij”. Është pikërisht ky vlerësimi i Kreut të Shtetit Shqiptar, në mjediset e Presidencës, në prani të shumë personaliteteve shtetërore, politike e shoqërore, me rastin e akordimit të titullit të lartë “Mjeshtër i Madh”, Prof.dr.Sali Kurtit, me motivacionin: “Për kontributin shumëvjeçar në fushën e stomatologjisë, dhënë me ndërgjegje, përkushtim e profesionalizëm të lartë në ndihmë të popullsisë së rrethit të Matit, si dhe në vlerësim të punës së tij në drejtim të përsosjes së shërbimit mjekësor dentar”.

Pikërisht për këto merita dhe veçanërisht për shpirtin human, vlerat njerëzore dhe intelektuale që mishron dhe përçon tek publiku i gjerë, AI e meriton plotësisht edhe titullin “Personaliteti i Vitit” që i akordoi Federata e Paqes Universale. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Prof.dr.Sali Kurti, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë...

